

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Vendim Nr. 460, datë 29.6.2022 “Për Miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021/2027”; Vendim Nr. 700, datë 12.10.2016, i Këshillit të Ministrave ”Për miratimin e Strategjisë kombëtare për konsolidimin e tokës në Shqipëri”. Programi Qeverisës 2021-2025
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	06.02.2025 deri me 06.03.2025
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	22/04/2025
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 03/03/2025
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2025 - MBZHR- Nr.1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TËPERSONIT TË KONTAKTIT)	Adra Gjongecaj e-mail-i: Adra.gjongecaj@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0692325402 Entela Kola e-mail-i: Entela.kola@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0688535551 Mimoza Shahini e-mail-i: Mimoza.Shahini@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0693937433
PJESA 1: PËRMBLEDHJEEKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	
<i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i>	

Tokat bujqësore përbëjnë një nga burimet më të rëndësishme natyrore të vendit, me një rol të pazëvendësueshëm në sigurinë ushqimore, zhvillimin rural dhe ekonominë kombëtare. Megjithatë, në dekadat e fundit, ky burim ka qenë nën trysni të vazhdueshme për shkak të faktorëve të shumtë si fragmentarizimi i pronësisë, mungesa e regjistrimit të plotë, shëndërrimi i qëllimit të përdorimit, mungesa e infrastrukturës dhe e investimeve. Për më tepër, mungesa e një vizioni afatgjatë për administrimin e tokës bujqësore ka ndikuar negativisht në efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e shfrytëzimit të saj. Identifikimi dhe adresimi i këtyre problematikave përbën një hap të domosdoshëm drejt zhvillimit të një sektori bujqësor konkurrues, të qëndrueshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor.

Problematikat e evidentuara kanë përgjithësisht natyrë rregullatore dhe paraqiten si më poshtë:

- Mungesë e qartësisë mbi pronësinë e tokës.
- Vështirësi në ruajtjen dhe ndryshimin e statusit të tokës bujqësore.
- Të dhëna jo të plota kadastrale.
- Rastet e mbivendosjeve dhe mungesës së titujve të qartë.

Tregu formal i pazhvilluar:

- Më pak se 2% e familjeve rurale kanë shitur tokë (1991–2007).
- Vetëm 3.6% e tokave janë dhënë me qira.
- Mbizotëron tregu informal i tokës në zonat rurale.

Situata e Konsolidimit të tokës:

Konsolidimi i tokës është në nivele të ulëta për shkak të:

- Mungesës së dokumentacionit të pronësisë.
- Mungesës së të dhënave të sakta kadastrale.
- Mospërdorimit të konsolidimit si **instrument zhvillimi**, ndryshe nga BE.

1. Vështirësitë në verifikimin e pronësisë dhe mungesa e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Një nga problematikat kryesore që shoqëron përdorimin e tokave bujqësore është mungesa e të dhënave të sakta dhe të përditësuara mbi regjistrimin dhe pronësinë e tyre. Pavarësisht përpjekjeve për të përmbyllur procesin e regjistrimit fillestar, ende ekzistojnë sipërfaqe të konsiderueshme që nuk janë të regjistruara në kadastër ose që rezultojnë me konflikte pronësie, sidomos në zonat rurale dhe ato malore. Kjo krijon pasiguri juridike për pronarët aktualë ose potencialë të tokave, duke ndikuar negativisht në motivimin për të investuar në to dhe duke penguar zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë.

2. Fragmentarizimi i tokës bujqësore dhe pamundësia për zhvillimin e ekonomive të shkallës.

Një tjetër çështje e rëndësishme është fragmentarizimi i tokës bujqësore, si rrjedhojë e procesit të ndarjes së saj në mënyrë të barabartë mes trashëgimtarëve pas viteve '90. Kjo ka sjellë ndarjen e sipërfaqeve në parcela shumë të vogla dhe shpesh të ndara nga njëra-tjetra, duke e bërë të vështirë organizimin e një ferme funksionale dhe me produktivitet të lartë. Në këtë kontekst, mungesa e një tregu aktiv për qiradhënien apo blerjen e tokës pengon konsolidimin e parcelave dhe për rrjedhojë, krijimin e ekonomive të shkallës, që janë thelbësore për konkurrueshmërinë në tregjet bujqësore.

3. Mungesa e një administrimi të integruar dhe të qëndrueshëm të tokës bujqësore

Administrimi i tokës bujqësore nuk është zhvilluar në mënyrë të integruar dhe të qëndrueshme. Politikat për administrimin e tokës shpesh kanë qenë të fragmentuara dhe

të paqëndrueshme në kohë, duke rezultuar në mungesë koordinimi mes institucioneve përgjegjëse për bujqësinë, mjedisin, zhvillimin rural dhe planifikimin territorial. Kjo ka bërë që shumë prej tokave të mbeten të pashfrytëzuara ose të kthehen në zona të braktisura, duke humbur gradualisht funksionin e tyre prodhues. Për më tepër, mungesa e një sistemi të qartë për monitorimin dhe kontrollin e përdorimit të tokës ka ndikuar në keqpërdorimin ose shfrytëzimin informal të saj.

4. Rënia e sipërfaqeve të përdorura për bujqësi dhe shndërrimi i tokës bujqësore në destinacione të tjera

Tendenca e përgjithshme e shndërrimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore apo për qëllime të tjera jo-prodhuese paraqet një tjetër rrezik serioz për sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural. Urbanizimi i pakontrolluar, mungesa e zbatimit të planeve të zhvillimit të territorit dhe presioni për ndërtim në zonat me potencial të lartë bujqësor kanë bërë që shumë toka të humbasin destinacionin e tyre fillestar. Kjo ndikon jo vetëm në reduktimin e sipërfaqeve të mbuluara me kultura bujqësore, por edhe në strukturën e përgjithshme të territorit dhe në balancën mjedisore.

5. Mungesa e investimeve dhe aksesit në infrastrukturë

Tokat bujqësore, veçanërisht ato që ndodhen në zona të thella ose më pak të zhvilluara, përballen me mungesë infrastrukture themelore, si rrugë, ujë, ujë, sistem kullimi dhe akses në energji elektrike. Këto mungesa përbëjnë një pengesë të drejtpërdrejtë për zhvillimin e bujqësisë moderne dhe për tërheqjen e investimeve private. Në shumë raste, fermerët përballen me vështirësi serioze për të çuar prodhimin në treg, duke ulur përfitimin dhe qëndrueshmërinë e aktiviteteve bujqësore.

Grupet e ndikuar janë:

- o Operatorët e bizneseve;
- o Qeveria;
- o Fermerët;
- o Shoqëria civile;
- o Prodhuesit e blegtorisë;
- o Industria përpunuese/prodhuese e produkteve me origjinë shtazore;
- o Punëmarrësit.

Nëpërmjet kësaj nisme synohet të rritet efienca e përdorimit të tokave bujqësore në administrim të MBZHR dhe të shtetit, kujdesi dhe mbrojtja e tokës bujqësore në tërësi dhe të fertilitetit të saj. Eliminimi i problematikave lidhur me keqpërdorimin e tokave bujqësore, dëmtimin e tyre, mosshfrytëzimin e tyre etj. Qëllimi kryesor i nismës është ofrimi i mbrojtjes maksimale të tokave bujqësore, rritja e mundësisë për qiradhënie dhe shfrytëzimi sa më efektiv të tokave bujqësore, rritjes së prodhimit bujqësor përmes metodave që parashikon ky propozim, ulje e shpenzimeve energjitike, ujore dhe përdorim i teknologjive më inovative të përdorura sot në bujqësinë europiane me pasojë rritjen ekonomike për fermerin, shoqërinë, qeverinë etj. Adresimi i problematikave të evidentuara duke përditësuar dhe përcaktuar metoda dhe rregulla të reja, inovative dhe të përshtatshme lidhur me tokën bujqësore e cila ka rëndësi thelbësore për bujqësinë dhe zhvillimin e saj duke qënë në qendër të politikave të Qeverisë së Shqipërisë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore të politikës së këtij projektligji janë siç vijon:

1. Sigurimi i zbatimit të teknologjive bujqësore inovative në tokat bujqësore për të rritur konkurrueshmërinë, produktivitetin dhe të ardhurat nga bujqësia, brenda vitit 2025;
2. Rritja me 20% e përdorimit të teknologjive inovative në bujqësi, si aeroponia, akuaponia dhe hidroponia, brenda një afati prej 5 vitesh nga momenti i miratimit të nismës¹.
3. Rritja me 20% të nivelit të investimeve inovatore nga subjektet private në sektorin bujqësor dhe të peshkimit, brenda një afati prej 5 vitesh nga miratimi i nismës.
4. Krijimi i rreth 700 vende të reja pune përreth zonë ku do të kryhen investimet brenda një periudhë prej 5 vitesh nga miratimi i nismës;
5. Rritja me 10% e nivelit të eksporteve të produkteve bujqësore të prodhuara në vend brenda 5 viteve nga miratimi i nismës;
6. Shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe efikas i tokave bujqësore me fertilitet të ulët, të cilat aktualisht nuk shfrytëzohen., përafërsisht me 300 ha brenda një periudhe prej 5 vitesh nga miratimi i nismës.
7. Inkurajimi i praktikave të bujqësisë organike duke ofruar mbështetje financiare dhe teknike për fermerët;
8. Rritja e sipërfaqes së tokës organike me 50 ha brenda një periudhë prej 5 vitesh nga miratimi i nismës;
9. Krijimi i programeve kombëtare për trajnimin e fermerëve dhe punonjësve të sektorit bujqësor mbi teknologjitë moderne dhe praktikat e mira, brenda vitit 2026.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së; Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma për ndryshime legjislative, nënkupton mos dhënien e një zgjidhjeje problematikave të evidentuara, mos adresimin e tyre dhe mos pasurimin me risi të ligjit në fuqi.

Opsioni 1 - (rregullator): Miratimi i një ligji të ri dhe shfuqizimi i ligjit aktual “Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” nuk jep zgjedhjen e duhur lidhur me problematikat të cilat janë evidentuar. Ky opsion nuk është i përshtatshëm, nuk trajton apo zgjidh një sërë çështjesh problematike në kohë, duke mos dhënë rezultatet e duhura.

Opsioni 2 - (rregullator): Rishikimi i ndryshimeve ligjore në ligjin aktual “Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, rregullon disa çështje në fushën e mbrojtjes së tokës bujqësore. Parashikon përfshirjen e një sërë risish me të cilat do të zgjidhen në kohë dhe me afate të arsyeshme ku përmes tyre do të sigurohen arritjet e rezultateve të kënaqshme në përputhje me qëllimin për përqasje me modele të ngjashme të vendeve me bujqësi të zhvilluar.

Opsioni 3 – (jorregullator): Ky opsion do të ishte forcimi i zbatimit të ligjit egzistues në fuqi nga strukturat kompetente. Trajnimi i stafit, forcimi i kërkesës së llogarisë, analizimi i terrenit më i shpeshtë etj. Qeveria mund të fokusohet në forcimin e zbatimit të

¹ Lidhur me impaktin që do ketë teknologjia në sektorin e bujqësisë vlen të përmendet që ky është një indikator makro dhe performanca e sektorit bujqësor në vlerë monetare llogaritet nga INSTAT, për të bërë një vlerësim të tillë do kërkohej një analizë *ex ante* dhe *post ante* i impaktit të teknologjisë, nëpërmejet studimeve sektoriale.

rregulloreve dhe legjislacionit ekzistues, trajnimeve dhe mbikëqyrjes më të fortë të institucioneve dhe operatorëve të biznesit në këta sektorë.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni i preferuar është **Opsioni 2 (rregullator)**: Miratimi i ndryshimeve ligjore ofron kuadrin ligjor rregullator për mbrojtjen e tokës bujqësore duke siguruar që ligji të jetë në një linjë me risitë që parashikojnë standartet europiane.

Grupet e prekura:

Projektligji ndikon në mënyra të ndryshme mbi këto grupe:

1. Qeveria:

- Nxiti punësimin dhe rrit të ardhurat nga tregtia dhe eksporti.
- Plotëson standartet e BE-së për sektorin bujqësor dhe blektorinë, duke përmirësuar imazhin ndërkombëtar.
- Përfitime nga subvencionet dhe grantet e BE-së dhe investime në laboratorë dhe teknologji moderne.

2. Fermerët:

- Duhet të përmbushin masa të reja biosigurie dhe standarde fermash.
- Përfitime nga rritja e të ardhurave, standardeve të jetesës dhe akses në subvencione.

3. Komuniteti dhe shoqëria civile:

- Përfitime sociale përmes modernizimit të sektorit bujqësor dhe përmirësimit të cilësisë së produkteve.
- Hapja e vendeve të punës dhe përmirësimi i jetesës në zonat rurale.
- Modernizimi i bujqësisë dhe diversifikimi i aktiviteteve në zonat rurale krijon bazën për një bujqësi të qëndrueshme në vend.
- Transformim të suksesshëm të forcës së punës nga aktivitete të lidhura me bujqësinë drejt atyre jobujqësore. Përmirësimi i standardeve të jetesës në sektorin rural krijon mundësi punësimi përmes diversifikimit dhe zhvillimit të mundësive për gjenerimin e të ardhurave në sektorin e bujqësisë.

4. Punëmarrësit:

- Mundësi të reja punësimi dhe zhvillimi profesional.
- Përmirësim i kushteve të punës dhe hapje e vendeve të punës në zonat rurale.

Ndikimet Kryesore të Projektligjit:

1. Sociale:

- Nxiti rritjen e jetesës përmes punësimit dhe zhvillimit rural.
- Modernizimi i industrisë përmirëson sigurinë ushqimore dhe ofron produkte cilësore dhe prodhimtari me rezultate të larta dhe me cilësi të produkteve bujqësore.
- Përfitime për komunitetet rurale nga zhvillimi ekonomik dhe social.

2. Ekonomike:

- Rritja e eksportit dhe tregtisë forcon ekonominë kombëtare.
- Investimet në standarde dhe teknologji krijojnë kosto fillestare, por përkthehen në përfitime afatgjata për të gjitha palët.
- Hapja e tregjeve të reja nxiti investime të huaja dhe rrit të ardhurat e qeverisë.

3. Mjedisore:

- Zhvillimi i sektorit bujqësisë përmes përfshirjes së metodave teknologjike inovative sjell përfitime jo vetëm në sektorin e bujqësisë, por në zonat rurale pritë të ketë ndikim në ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Përdorimi i teknologjive të avancuara gjithashtu redukton konsumin e energjisë dhe ndotjen mjedisore.
- Zbatimi të Kushteve të Mira Bujqësore dhe Mjedisore (KMBM) përveç parashikimeve për zbatimin e standardeve minimale ligjore të cilat janë të detyrueshme për përfituesit e mbështetjes së të ardhurave dhe të pagesave kompensuese gjithashtu synojnë të kontribuojnë në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, në mbrojtjen e ujit, tokës dhe biodiversitetit.

Kosto dhe Përfitime:

- **Kosto të Sektorit Privat:** Përfshijnë investime fillestare për përmbushjen e standardeve, modernizimin e teknologjisë dhe trajnimin e personelit. Edukimi dhe trajnimi mund të paraqesin kosto pasi inovacionet teknologjike kërkojnë një nivel të caktuar njohurish dhe aftësish nga fermerët. Gjithashtu mund të paraqitet nevoja e caktimit të një tekniku për teknologjitë që do të përdoren dhe kjo shton nevojën për punëmarrje shtesë për fermerin. Për të realizuar potencialin e plotë të teknologjive inovative në bujqësi, është e rëndësishme të investohet në edukimin e fermerëve, të mbështetet kërkimi shkencor dhe të krijohen politika që inkurajojnë adoptimin e teknologjive të reja. Prandaj, programet e edukimit dhe trajnimeve janë të domosdoshme për të maximizuar përfitimet nga këto teknologji.
- **Përfitime të Sektorit Privat:** Rritje e produktivitetit si rezultat i përdorimit të teknologjive të reja, përmirësimi i cilësisë të produkteve bujqësore, rritje e eksporteve si dhe rritje e të ardhurave nga prodhimi, tregëtimi dhe eksporti. Përdorimi i burimeve të energjisë së rinovueshme, si panelet diellore dhe energjia nga biomasa, kontribuojnë në një bujqësi më të qëndrueshme dhe ulë kostot operative. Po kështu paraqitet mundësia e shitjes së energjisë elektrike kur fermieri gjykon se e ka më shumë se sa i nevojitet. Po kështu ulët nevojën për përdorimin e ujit për vadije. Teknologjitë inovative mund të optimizojnë përdorimin e burimeve natyrore si uji, plehurat kimike dhe pesticidet. Kjo redukton ndikimin negativ në mjedis dhe siguron një bujqësi më të qëndrueshme afatgjatë. P.sh, softëerët e menaxhimit të fermave mund të ndihmojnë fermerët të planifikojnë mbjelljet, të monitorojnë shëndetin e bimëve dhe të optimizojnë shitjet.
- **Kosto të Sektorit Publik:** Nuk identifikohen kosto të reja të konsiderueshme për sektorin publik, pasi kompetencat do të ushtrohen nga strukturat ekzistuese. Por, qeveritë detyrohen të hartojnë politika që inkurajojnë adoptimin e teknologjive të reja nga fermerët. Gjithashtu, është e rëndësishme të sigurohet që politikat të jenë të përshtatshme për fermerët e vegjël dhe të mesëm, të cilët mund të kenë vështirësi në adoptimin e teknologjive të reja.
- **Përfitime të Sektorit Publik:** Përfitimet përfshijnë rritjen e të ardhurave nga taksat, si dhe përmirësimin e mirëqenies së shoqërisë në plan afatgjatë. Inovacionet teknologjike kërkojnë një nivel të caktuar njohurish dhe aftësish nga stafi administrativ prandaj, programet e edukimit dhe trajnimeve janë të domosdoshme për të maksimizuar përfitimet nga këto teknologji dhe metoda të zbatimit sipas parashikimeve të projekligjit. Rritja e investimeve nga subjektet private në sektorin bujqësor dhe të peshkimit pritë të përkthehen në rritje të prodhimit bujqësor dhe të peshkimit. Investimet mund të financojnë teknologji të reja, praktika më të mira bujqësore, zgjerim të fermave dhe flotave të peshkimit, gjë që çon në rritje të sasisë dhe cilësisë së produkteve bujqësore dhe të peshkimit. Rritja e eksporteve të produkteve të prodhuara, sidomos për akuakulturat, duke patur

parasysh që prodhimi i BE përfaqëson 1% të prodhimit global dhe importon 60% të saj, nga subjektet që do të investojnë në këtë sektor.

Qëllimi kryesor i këtij propozimi për ndryshime ligjore është ofrimi i mbrojtjes maksimale të tokave bujqësore, rritja e mundësisë për qiradhënie dhe shfrytëzim sa më efektiv për tokat bujqësore, rritje të prodhimit bujqësor përmes metodave inovative, uljen e shpenzimeve energjitike, ujore dhe përdorimin e teknologjive inovative që përdoren sot në bujqësinë europiane kështu me pasojë rritjen ekonomike për fermerin, shoqërinë, qeverinë etj. Adresimi i problematikave të evidentuara duke përditësuar dhe përcaktuar metoda dhe rregulla të reja, inovative dhe të përshtatshme në tokën bujqësore e cila ka rëndësi thelbësore për bujqësinë dhe zhvillimin e saj duke qenë në qendër të politikave të qeverisë së Shqipërisë.

Opsioni i përzgjedhur nga ana jonë parashikon investime fillestare të konsiderueshme, por pritshmëritë për ndikime afatgjata janë të larta dhe me rezultate pozitive sociale, ekonomike dhe mjedisore duke justifikuar kështu kostot. Rritja e eksporteve dhe përmbushja e standardeve të BE-së mbi cilësinë e produkteve dhe sigurinë ushqimore pritet të kenë një ndikim pozitiv për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe të vendit më gjërë, duke mbështetur kështu edhe objektivat kombëtare për integrim europian dhe mirëqenie të shtuar për shoqërinë.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar:

Nga analiza me shumë kritere e kryer për të tre opsionet tregoi se **Opsioni 2**, hartimi i projektaktit “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” është vlerësuar me më shumë pikë duke e zgjedhur nga ana jonë si opsionin e preferuar. Ky opsioni është zgjedhur si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm.

Opsioni 2–(rregullator)- Miratimi i këtyre ndryshimeve ligjore konsiderohet se ofron mënyrën më të mirë për të arritur objektivat. Ky opsion ofron qasjen më të mirë për thjeshtimin, qartësinë, koherencën dhe reduktimin e barrës administrative. Me miratimin e këtyre ndryshimeve ligjore synohet të rritet efica e përdorimit të tokave bujqësore në administrim të shtetit, kujdesi dhe mbrojtja e tokës bujqësore në tërësi dhe të fertilitetit të saj. Eliminimi i problematikave lidhur me keqpërdorimin e tokave bujqësore, dëmtimin e tyre, mosshfrytëzimin e frytshëm të tyre etj. Qëllimi kryesor i këtij propozimi për ndryshime ligjore është ofrimi i mbrojtjes maksimale të tokave bujqësore, rritja e mundësisë për qiradhënie dhe shfrytëzimi sa më efektiv për tokat bujqësore, rritje të prodhimit bujqësor përmes metodave që parashikon ky propozim, ulje e shpenzimeve energjitike, ujore dhe përdorim i teknologjive më inovative të përdorura sot në bujqësinë europiane me pasojë rritjen ekonomike për fermerin, shoqërinë, qeverinë etj. adresimi i problematikave të evidentuara duke përditësuar dhe përcaktuar metoda dhe rregulla të reja, inovative dhe të përshtatshme lidhur me tokën bujqësore e cila ka rëndësi thelbësore për bujqësinë dhe zhvillimin e saj duke qenë në qendër të politikave të qeverisë së Shqipërisë.

Për rrjedhojë, Opsioni 2 do të ketë një ndikim pozitiv në përfitueshmërinë dhe rritjen ekonomike të sektorëve të përfshirë.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	0	0

KONSTULTIMI

Metodat e përdorura gjatë Konsultimit Publik janë:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrisë Elektronike, REKNJP, nga data 06.02.2025 deri në datë 06.03.2025;
2. Komunikimi përmes postës elektronike.

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribute në konsultimin publik, konkretisht përmes postës elektronike, gjatë procesit të hartimit, janë:

1. Firma ligjore “Shehu&Partners” me komentet janë siç vijon:

- Komenti: Sugjerimi për ndryshimin e gërmasë b), pika 5 e nenit 14, ku është parashikuar që: “Ndërtimin e infrastrukturës dhe veprave ndihmëse për prodhimin dhe transmetimin dhe jo vetëm të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme agrifotovoltaike, si dhe ndërtimin e infrastrukturës për vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme për tokat me bonitet 7 dhe 8”. Ndërkohë, që me ndryshimet të cilat synohen të kryhen nëpërmjet këtij projektligji parashikohet ndryshimi i bonitetit të tokës nga 7 deri në 10.

Sugjerojmë se, nuk ka nevojë për këtë ndryshim pasi vetë ligji parashikon se strukturat që duhet të instalohen për ushtrimin e aktivitetit të agrifotovoltaikut lejohen të ndërtohen në toka bujqësore me bonitet 9 dhe 10.

Lidhur me këtë sugjerim ministria sqaron se ky sugjerim nuk qëndron, pasi gërma “c” i referohet vetëm aktivitetit fotovoltaiik dhe jo agrifotovoltaiik, i cili, sipas përkufizimit të dhënë në ligj, është aktiviteti mbi tokën bujqësore, ku zhvillohen njëkohësisht prodhimi bujqësor në mënyrë të pandërprerë i kombinuar me ndërtimin, shfrytëzimin, operimin, prodhimin, tregtimin, shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme fotovoltaiike (nga dielli).

- Komenti: shkronja b), pika 5 e nenit 14 të projektligjit ky ndryshim i bërë, nuk është në përputhje me pikën “d” të ligjit, në të cilën autorizohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë norma rregulluese për aktivitetin agrifotovolatik me akt nënligjor vetëm për tokat bujqësore me bonitet deri në 8.

Lidhur me këtë koment ministria sqaron se ky koment qëndron, pasi duhet bërë ndryshimi dhe tek kjo pikë për bonitetin deri në 10, duke qënë se VKM për rregullimin e arifotovoltaikut është parashikuar për zbatimin e pikës b). Ky sugjerim është reflektuar në projektin e hartuar.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi i opsionit të zgjedhur do të realizohet në përputhje me dispozitat përcaktuese të këtij projektligji siç vijon:

- a) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- b) Komiteti Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës (KSHMT);

- c) Struktura përgjegjëse për inspektimin e mbrojtjes së tokës bujqësore;
- ç) Këshilli i Qarkut;
- d) Komisioni i Mbrojtjes së Tokës (KMT) në qark;
- dh) Struktura përgjegjëse për inspektimin e mbrojtjes së tokës bujqësore në qark;
- e) Këshillat e Bashkive;
- ë) Kryetari i Bashkisë.

- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, është përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën mbrojtjes dhe shfrytëzimit të tokave bujqësore në administrim të MBZHR-së. Si autoriteti kompetent qëndror MBZHR koordinon punën e institucioneve të varësisë. MBZHR-së, përmes strukturave të saj, ka objekt veprimtarie ruajtjen dhe rehabilitimin e tokës bujqësore nga veprimi i dëmshëm i faktorëve klimatikë dhe njerëzore, të tilla si degradimi i tokës, erozioni, si dhe ndërtimet e paligjshme. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ushtron drejtimin teknik dhe administrativ të të gjitha strukturave shtetërore të ngarkuara me mbrojtjen e tokës.

- **Komiteti Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës**, nën drejtimin e Ministrit të Bujqësisë, krijohet si organ ndërmënyror dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi të bashkërendojë punën e MBZHR, Ministrisë së Mjedisit, institucioneve të tjera, si dhe organeve të qeverisjes vendore, të ngarkuara nga ligji për mbrojtjen e tokës.

- **Këshilli i Qarkut**, me strukturat në varësi të tij, ka këto detyra: drejtimin administrativ dhe teknik të të gjitha strukturave shtetërore në territorin e qarkut që ky ligj i ngarkon për mbrojtjen e tokës bujqësore; nxjerrjen e vendimeve të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha organet e pushtetit vendor në territorin e qarkut; për masat konkrete të mbrojtjes së tokës bujqësore; për miratimin e fondeve të nevojshme për mbrojtjen dhe rehabilitimin e tokës bujqësore mbi bazën e propozimeve të paraqitura nga KMT-ja ose IMT-ja e komunave etj.

- **Komisioni i Mbrojtjes së Tokës** ka këto detyra: bashkërendimin e veprimtarive për mbrojtjen e tokës bujqësore pranë Këshillit të Qarkut krijohet Komisioni i Mbrojtjes së Tokës (KMT); organizon grupe të veçanta me specialistë të institucioneve të ndryshme në territorin e qarkut për të verifikuar, kontrolluar ose studiuar çështje të veçanta për masat mbrojtëse për tokën bujqësore etj.

- **Këshilli Bashkisë**: Kryetari i bashkisë ka këto detyra: të bëjë kontrollin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji brenda juridiksionit të tij; të nxjerrë vendime të detyrueshme për zbatim, për mbrojtjen e tokës bujqësore nga pronarët dhe poseduesit e ligjshëm të tokës bujqësore, si dhe për persona fizikë e juridikë, veprimtaria e të cilëve në çfarëdo lloji mënyre ndikon mbi funksionet që përmbush toka bujqësore; të shqyrtojë raportet e kontrolleve për dëmtimin e tokave bujqësore dhe të nxjerrë vendimet përkatëse etj.

- Detyra të tjera të strukturave shtetërore për mbrojtjen e tokës bujqësore bëjnë inspektimin e tokave bujqësore; monitorimin etj.

Inspektoriati i Tokës pranë MBZHR-së, ka objekt veprimtarie ruajtjen dhe rehabilitimin e tokës bujqësore nga veprimi i dëmshëm i faktorëve klimatikë dhe njerëzore, të tilla si degradimi i tokës, erozioni, si dhe ndërtimet e paligjshme. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ushtron monitorimin e të dhënave, drejtimin teknik dhe administrativ të të gjitha strukturave shtetërore të ngarkuara me mbrojtjen e tokës. Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës për çdo 6 muaj ka për objektiv dhe përmbush këto detyra, që do të shërbejnë edhe si masa/mekanizma mbështetës për monitorimin e zbatueshmërisë së opsionit të preferuar

Historik

Erozioni mund të përkufizohet si konsumimi i sipërfaqes së tokës nga forcat fizike të tilla si reshjet, uji i rrjedhshëm, era, akulli, ndryshimi i temperaturës, graviteti ose agjentë të tjerë natyrorë ose antropogjenë që gërryejnë, shpëputin dhe largojnë dheun ose materialin gjeologjik nga një pikë e tutje. sipërfaqja e tokës të depozitohet diku tjetër. Kur përdoret në kontekstin e presioneve në tokë, erozioni i referohet humbjes së përshtetshme të tokës si rezultat i aktivitetit antropogjen, mbi normat e pranueshme të formimit natyror të tokës. Humbja e tokës çon në një rënie të përmbajtjes së lëndës organike dhe lëndëve ushqyese, në prishjen e strukturës së tokës, në një reduktim të ujit të depozituar të tokës në dispozicion, gjë që mund të çojë në një rrezik të shtuar nga përmbajtjet dhe rrëshqitjet e dheut në zonat ngjitur. Cikli i lëndëve ushqyese dhe i karbonit mund të ndryshohet ndjeshëm nga mobilizimi dhe depozitimi i tokës, pasi toka e gërryer mund të humbasë 75% - 80% të përmbajtjes së saj të karbonit, me rrjedhim të çlirimit të karbonit në atmosferë. Erozioni i tokës ndikon fuqishëm në mjedis dhe ka kosto të larta ekonomike. Për të zbutur këto efekte, kërkohen hartimi i strategjive të ruajtjes së tokës dhe ujit².

Reforma e tokës e 1991-it, e cila solli një ndryshim radikal në zotërimin e tokës dhe të drejtat e pronësisë mbi tokën bujqësore (nga pronësia shtetërore në atë private), është një prej reformave më të mëdha të ndërmarra në Shqipëri deri më sot. Me zbatimin e ligjit nr. 7501 “Për tokën”, toka u nda në mënyrë të barabartë midis anëtarëve të kooperativës dhe punonjësve të fermave shtetërore, në përputhje me cilësinë dhe prodhimtarinë e tokës, si dhe numrin e anëtarëve të familjes, që figuronin të regjistruar në gjendjen civile, në muajin gusht të vitit 1991. Një prej efekteve më pozitive të reformës së tokës ishte kalimi i një pasurie jetike siç është toka, në dobi të familjeve rurale. Megjithatë, shkalla e lartë e fragmentarizimit dhe krijimi i fermave të vogla, çojnë në uljen e prodhimit bujqësor, përdorimin e teknologjive joadequate, degradimin e tokës, si dhe impakte të tjera negative në sektorin bujqësor me ndikim të theksuar mbi shumicën e popullsisë rurale. Infrastruktura e varfër rurale dhe të ardhurat e ulëta janë një faktor kryesor që ka ndikuar në migracionin e popullsisë drejt zonave urbane dhe jashtë vendit.

Bujqësia ka qenë dhe është një nga veprimtaritë ekonomike më të rëndësishme për vendin tonë. Aktualisht bujqësia mbetet dega bazë e ekonomisë së vendit, për disa arsye:

- përqindja e madhe e popullsisë që banon në rajonet bujqësore ka burim kryesor të ardhurat nga veprimtaria bujqësore;
- niveli i ulët i industrializimit;

Objektivi i përgjithshëm i bujqësisë është rritja e qëndrueshme e prodhimit, duke arritur:

- përmirësimin e furnizimit të tregut për konsum dhe të subjekteve përpunuese;
- zvogëlimin e raportit eksport – import;

² Treguesit janë vlerësime të parashikuara dhe jo vlera reale. Ato rrjedhin nga një version i përmirësuar i modelit të Ekuacionit Universal të Rishikuar të Humbjes së Tokës i zhvilluar për të vlerësuar erozionin e tokës nga uji në një shkallë rajonale. Struktura e modelit është përshtatur për të marrë parasysh planifikimin e ruajtjes, shkallën e erozionit të inventarit dhe vlerësimin e shpërndarjes së sedimentit në bazë të njohurive të pranueshme shkencore dhe gjyqimit teknik. Në këtë vlerësim, modeli bazë RUSLE është përshtatur përmes përmirësimit të cilësisë së faktorëve të hyrjes. Marrë nga faqja zyrtare e BE-së https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Agri-environmental_indicator_-_soil_erosion.

- rritjen e nivelit ekonomik të familjeve bujqësore etj.

Në këtë drejtim, pavarësisht bilancit negativ të import eksportit, tre vitet e fundit është verejtur një rritje e eksportit shqiptar me vendet e rajonit dhe më tej. Këtu vlen të përmendet fakti që prodhimi vendas ka pësuar rritje që vjen si pasojë e rritjes së sipërfaqes së mbjellë, por dhe si rrjedhojë e rritjes së rendimentit të kulturave bujqësore. Këto rritje reflektohen si në prodhim ashtu edhe në vlerë. Për sa më sipër, ndikim të ndjeshëm ka dhe ndryshimi i strukturave të mbjelljes në favor të kulturave më të kërkuara në treg dhe që japin të marzh më të madh fitimi për fermerin shqiptar.

Deri në vitin 2016, mbi 80% e të gjitha zonave në vendet e BE-së ishin vlerësuar si të prekura nga erozioni deri në një masë e cila varionte nga mesatarja deri në një masë më të rëndë dhe të cilat ishin identifikuar si toka bujqësore dhe kullota natyrore.

Përqindja e tokave bujqësore dhe kullotave natyrore që vlerësoheshin të ndikuara nga erozioni i tillë, ra me 2.6 pikë përqindjeje në BE, mes viteve 2000 deri në vitin 2016. Performanca e sektorit bujqësor ka qenë tradicionalisht rreth asaj se sa e suksesshme është bujqësia në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve primare bujqësore. Megjithatë, ajo po merr gjithnjë e më shumë kuptimin e bujqësisë duke njohur ndikimin e saj në cilësinë e ujit, ajrit dhe tokës, diversitetin e përdorimit të tokës, ekologjitë, kafshët e egra dhe ndryshimet klimatike.

Marrëveshja e Gjellbër Evropiane ka përcaktuar mënyrën se si Evropa do të bëhet kontinenti i parë neutral ndaj klimës deri në vitin 2050. Strategjia “*Nga ferma në tavolinë*” u miratua nga Komisioni Evropian më 20 maj 2020 dhe qëndron në qendër të Marrëveshjes së Gjellbër përmes së cilës parashikohen masat dhe politika për një sistem ushqimor të drejtë, të shëndetshëm dhe miqësor ndaj mjedisit. Ndër të tjera, aty trajtohen në mënyrë gjithëpërfshirëse sfidat e sistemeve të qëndrueshme ushqimore. Marrëveshja e Gjellbër ka qëllim ndër të tjera rritjen e sipërfaqes së bujqësisë organike në 25% nga sipërfaqja bujqësore e shfrytëzuar deri në vitin 2030. Një synim ky që shkon paralelisht me masat për të ndryshuar performancën e burimeve natyrore. Objektivi tjetër po aq i rëndësishëm është reduktimi i varësisë nga pesticidet kimike dhe antimikrobikët, reduktimi i plehërimit të tepërt dhe pakësimi i mbetjeve do të hapin rrugën për një zinxhir ushqimor më të qëndrueshëm. Për BE-në vlerësimi i performancës së sektorit bujqësor ka rëndësi për një sërë arsesh:

- bujqësia është një gur themeli i komunitetit rural, nga i cili varen një sërë sektorësh siç janë teknologjitë inovative, kujdesi shëndetësor për kafshët, bizneset e inputeve, operatorët e biznesit që operojnë në sektorët e përpunimit të ushqimit, paketimit dhe transportit;
- bujqësia ka të bëjë me sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me ushqim të sigurt dhe cilësor;
- bujqësia ka një rol kyç në ruajtjen e biodiversitetit, peisazheve, ndryshimeve klimatike dhe për të mbështetur këtë, është e nevojshme të sigurohen të ardhura për fermerët³.

Ndërkaq Shqipëria si vënd nënshkrues i Axyhendës për Marrëvëshjen e Gjellbër, si dhe MBZHR si intitucion udhëheqës për zbatimin e statëgjjisë “*Nga ferma në tavolinë*” ka marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet përkatëse që burojnë prej tyre. Situata lidhur me bujqësinë në Shqipëri ka karakteristikat e saj mbështetur kjo në vendodhjen gjeografike, klimën, relievin, shpërndarjen e tokave bujqësore, historikun e rregullimeve ligjore në këtë fushë etj.

³ Burimi i inofrmacionit “Eurostat”.

Konkretisht, referuar të dhënave të marra nga INSTAT, rezulton se numri i të punësuarve në bujqësi ka ardhur në rritje sipas tabelës së mëposhtme.

VITET	2019	2020	2021	2022	2023
Total të punësuar	1,265,582	1,243,345	1,248,749	1,298,380	1,327,042
Të punësuar në bujqësi, nr	460,876	448,390	422,077	440,440	428,635
Të punësuar në bujqësi, %	36.4%	36.1%	33.8%	33.9%	32.3%

Ndërsa strukturat e tokës nga viti 2019 deri 2023 (në hektar) paraqiten⁴:

Sipërfaqja	2019	2020	2021	2022	2023
Tokë gjithsej	2874.9	2875.0	2875.0	2875.0	2875.0
Tokë bujqësore	696.0	687.6	687.5	686.4	678.4
Livadhe dhe kullota	478.1	478.1	448.8	449.2	366.1
Pyje	1051.8	1051.8	1146.7	1146.7	969.9
Toka të tjera	649.0	657.5	592.0	592.7	860.6

Ekonomia shqiptare ka përfituar prej stabilitetit makroekonomik dhe reformave ekonomike, të cilat kanë siguruar mundësi zhvillimi për sektorin privat dhe nxitjen e investimeve. Shqipëria është një vend me një nivel mesatar të ardhurash, me të ardhura vjetore për frymë në vlerën 484,000 lekë ose 3,457 euro dhe me rritje ekonomike të qëndrueshme. Rritja ekonomike në vitin 2013 në terma realë ishte 1.39% dhe 2.02 në vitin 2014. Më 2014-n, sektori bujqësor (bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi) zinte rreth 20% të PBB-së, ndërsa Vlera Bruto e Shtuar në sektorin bujqësor kapi një vlerë prej 280,036 milionë lekësh, duke kontribuar me 0.44 pikë përqindje në rritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe duke shënuar një rritje prej 5.6% krahasuar me vitin 2013.

Burimi kryesor i rritjes ekonomike gjatë periudhës së tranzicionit në bujqësinë shqiptare lidhet me një sërë faktorësh (toka, puna dhe kapitali), që në tërësinë e tyre nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim domethënës. Stabiliteti makroekonomik dhe liberalizimi ekonomik çoi në rishpërndarjen e burimeve nga sektorët më pak përfitues (drithërat) tek aktivitetet më me leverdi (pëmëtarja, perimet dhe mbarështimi i blegtorisë), të cilat i mundësuan bujqësisë rritjen e mëtejshme me më pak investime.

Nëse përmbledhim një historik mbi strukturën e tokës bujqësore private dhe situatën aktuale të fragmentimit të saj do rezultonte se shpërndarja e tokës bujqësore gjatë reformës së tokës në fillim të viteve '90, krijoi një strukturë sipërfaqesh të vogla e të fragmentuara. Sipas Vjetarit Statistikor të MBZHR (2011), në Shqipëri figurojnë rreth 388,697 familje fermere, ku sipërfaqja mesatare e tokës në pronësi të çdo familje fermere është rreth 1.26 ha të ndara në 4.7 parcela me një sipërfaqe mesatare për parcelë prej 0.27 ha. Referuar të dhënave të INSTAT-it, qershor 2014, në Shqipëri figurojnë rreth 352.315 familje fermere, ku sipërfaqja mesatare e tokës në pronësi të çdo familje fermere është rreth 1.16 ha. Rreth 46% e fermave kanë një sipërfaqe nën 1 ha, ndërsa 86% e tyre nën 2 ha. Sipërfaqja totale e tokës bujqësore prej 696,000 ha përfshin 24% të të gjithë territorit të vendit. Nga kjo sipërfaqe, rreth 562,000 ha ose 80% është në pronësi private dhe 134,000 ha ose 20% është në pronësi publike (shtetërore). Megjithatë, për shkak të ndërtimeve informale, zgjerimit të zonave urbane dhe tjetërsimit për investime publike fond i tokës bujqësore është zvogëluar dhe është në proces puna për saktësimin dhe pasqyrimin e tyre në dokumentacionin kadastral.

⁴ Shënim: Në të dhënat e vitit 2023 nuk përfshihet sipërfaqja e fondit kullosor dhe fondit pyjor që ndodhet brënda zonave të mbrojtura (si rrjedhojë këto të dhëna janë objekt rishikimi). Burimi informacionit INSTAD.

Nga sipërfaqja prej rreth 134,000 ha tokë bujqësore në pronësi shtetërore, 109, 500 ha janë toka të pandara të ish-kooperativave bujqësore – objekt i ligjit nr. 7501, miratuar më 1991 – tokë, që është refuzuar nga familjet rurale për shkak të fertilitetit natyral relativisht të ulët, distancës së largët nga qendrat e banuara, mungesës së infrastrukturës (rrugë, kanale ujitëse), pjerrësisë dhe vendndodhjes, përgjithësisht në zonat kodrinore-malore. Nga sipërfaqja e tokave të pandara, e cila është në administrim të bashkive për t'u dhënë me qira, 23,368 ha ka kaluar në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (VKM nr. 770, datë 12.4.2014; Fletore Zyrtare nr. 185, viti 2014). Në pronësi të shtetit përfshihen, gjithashtu, edhe rreth 25,000 ha tokë bujqësore, që ka qenë në pronësi të ish-fermave shtetërore, e pandarë për shkak të tejkalimit të normës së sipërfaqes së tokës për frymë (aktualisht në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural), që shërben si tokë për qiradhënie dhe për institucionet shtetërore në kuadër të kryerjes së detyrave të tyre institucionale. Struktura e tokës së kultivuar dominohej nga bimët e arave, pemët frutore, ullinjë, agrumet dhe vreshtat⁵.

Deri më tani në fushën e mbrotjes së tokës bujqësore është operuar në bazë të një kuadri legjislativ si në vijim:

➤ Ligje

1. Ligji Nr. 10 263 datë 8.4.2010 “Për përdorimin dhe shfrytësimin e tokave bujqësore të pakultivuara”;
2. Ligjit Nr. “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” i ndryshuar,
3. Ligji Nr. 8752 datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”;

➤ Vendime të Këshillit të Ministrave

1. Vendim Nr 221, datë 17.2.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki”;
3. Vendim Nr. 410 datë 27.6.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorisë së resurseve të tokës”;
4. Vendim Nr 45 datë 29.1.2014 “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Fondit të tokës bujqësore të ish ndermarrjeve bujqësore dhe ish institucioneve kërkimore shkencore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së kthimit dhe Kompensimit të Pronave”;
5. Vendim Nr 994 datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së akteve të marrjes së tokës në pronës” i ndryshuar”;
6. Vendim Nr 283 datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e tipave rregullave kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokën bujqësore” i ndryshuar;
15. Vendim Nr. 404, datë 19.6.2024 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për marrjen e masave parandaluese për përhapjen e zjarreve në tokat bujqësore”
16. Vendim Nr. 387, datë 12.6.2024 “Për kriteret për përdorimin e tokës bujqësore për kryerjen e aktivitetit agrifotovoltoik dhe eolik në tokat bujqësore, procedurat për monitorimin e ushtrimit të aktivitetit, përfshirë masat për shkeljen e kushteve të ushtrimit të aktivitetit dhe përcaktimin e tarifës”.

⁵ Vendim Nr. 700, datë 12.10.2016 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për konsolidimin e tokës në Shqipëri” fq. 1.

➤ Akte të tjera nënligjore

2. Udhëzim Nr. 10, datë 9.7.2020 “Për mënyrën e marrjes së mostrave për ndryshimin e kategorisë resursit nga tokë e pafrytshme dhe tokë urbane truall, nëntokë bujqësore dhe kryerjen e analizave”,

3. Udhëzim Nr. 8, datë 27.4.2020 “për një shtesë në Udhëzimin nr 5 datë 13.3.2017, “Për krijimin e informacionit mbi tokën bujqësore nga zbatimi i programit “Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore”.

- *Jepni kontekstin e politikës*

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*
- *Përshkruani natyrën e problemit.*

Në Shqipëri ende nuk është zhvilluar plotësisht një treg formal i tokës rurale (shitjet dhe qiradhënia). Që nga fillimi i privatizimit dhe deri në vitin 2007, më pak se 2% e familjeve rurale ka shitur tokën në tregun formal dhe vetëm 3.6% ka marrë me qira tokën e tyre. Sidoqoftë, është e dukshme që në tokat në zonat rurale tregu informal është mbizotërues. Problematikat e identifikuar janë të natyrës rregullatore, kjo mbështetur në shumë shkaqe që prekin aspekte siç janë: problematika e pronësisë së tokës bujqësore, standarti ligjor i ruajtjes së tokës bujqësore, përdorimi apo ndryshimi i statusit “tokë bujqësore” në një status të ndryshëm juridik (truall etj) etj. Në vijim po shtjellojmë çështje të rëndësishme parësore lidhur me objektin e çështjes në shqyrtim.

Problematikat në Sektorin e Bujqësisë dhe Blegtorisë në Shqipëri:

Përshkrimi i problematikave:

1. Fragmentarizimi i tokës bujqësore

Fragmentarizimi i tokës bujqësore është një nga problemet më të rëndësishme që ndikon negativisht në zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Shqipëri. Pas reformës së tokës në vitin 1991, shumë toka u ndanë në pronësi individuale, duke rezultuar në një numër të madh fermash të vogla. Sot, shumë fermerë zotërojnë parcela të vogla, që e bëjnë të vështirë të rrisin shkallën e ekonomisë. Kjo situatë kontribuon në uljen e rendimenteve dhe efektivitetit në përdorimin e burimeve natyrore.

Shkaqet:

- **Reforma e Tokës:** Ndërkohë që reforma ofroi pronësi për fermerët, ajo gjithashtu çoi në një ndarje të tepërt të tokës, duke krijuar probleme me administrimin dhe menaxhimin e saj.
- **Mungesa e Investimeve:** Shumica e fermerëve nuk kanë burime të mjaftueshme për të investuar në rritjen e sipërfaqeve të fermave, duke e bërë të vështirë për ta të konkurojnë në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Grupet e prekura nga ky problem:

Fermerët përballen me ulje të rendimentit dhe mundësi të kufizuar për zhvillim, duke i bërë ata të varur nga subvencionet dhe ndihmat e jashtme. Qeveria ka vështirësi në implementimin e politikave të zhvillimit rural për shkak të fragmentarizimit, duke penguar kështu rritjen e qëndrueshme të sektorit.

1. Mungesa e teknologjive të reja dhe praktikave bujqësore

Përdorimi i teknologjive të vjetra dhe metodave tradicionale të kultivimit në bujqësi ka rezultuar në uljen e rendimenteve dhe cilësisë së produkteve. Fermerët shpesh nuk kanë qasje në informacionin mbi praktikën e mira bujqësore dhe teknologjitë moderne, gjë që e bën të vështirë për ta të përballen me kërkesat e tregut.

Shkaqet:

- Mungesa e Financimeve: Investimet në teknologji të reja janë të pakta, kryesisht për shkak të kostove të larta dhe mungesës së burimeve financiare nga qeveria dhe institucionet private.
- Edukimi i Kufizuar: Shumë fermerë nuk janë të informuar mbi përfitimet e teknologjive të reja dhe metodave moderne të kultivimit, duke rezultuar në praktikë të paqëndrueshme.

Grupet e prekura nga ky problem:

-Fermerët dështojnë të rrisin prodhimin dhe cilësinë, duke u bërë të varur nga importet për të plotësuar kërkesat e tregut.

-Industria përpunuese merr produkte me cilësi të ulët, duke ndikuar negativisht në të ardhurat dhe konkurrencën në tregun global.

-Qeveria: Vështirësi në përmbushjen e standardeve të sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit, duke rritur shqetësimet për shëndetin publik.

2. Mungesa e infrastruktures rurale

Infrastruktura e varfër, si rrugët, sistemet e ujitjes dhe të tjera objekte të nevojshme për bujqësinë, është një faktor kufizues për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Shqipëri. Kjo pengon qasjen e fermerëve në tregje dhe rrit kostot e prodhimit, duke e bërë më të vështirë për ta konkurrimin në tregun e brendshëm dhe ndërkombëtar.

Shkaqet:

- Investime të Pamjaftueshme: Edhe pse janë bërë përpjekje për të përmirësuar infrastrukturën, investimet mbeten të ulta në krahasim me nevojat e sektorit.
- Prioritetet e Qeverisë: Fokusimi shpesh është në zhvillimin urban dhe në projekte të tjera, duke lënë pas dore investimet në infrastrukturën rurale.

Grupet e prekura nga ky problem:

-Fermerët kanë vështirësi në transportimin e produkteve, duke e bërë më të vështirë shitjen në tregje dhe zvogëluar fitimet.

-Qeveria: Dështim në përmbushjen e qëllimeve për rritjen e prodhimit dhe të ardhurave në zonat rurale, duke rritur varfërinë dhe pabarazinë.

3. Degradimi i mjedisit dhe erozioni i tokës

Përdorimi intensiv dhe jo i duhur i tokës bujqësore ka çuar në degradimin e mjedisit, ndotjen e ujit dhe ajrit, si dhe erozionin e tokës. Problemet mjedisore janë një shqetësim i madh për bujqësinë dhe jetesën në zonat rurale, duke rritur kostot dhe duke ulur cilësinë e jetesës.

Shkaqet:

- Praktikë e Paqëndrueshme: Përdorimi i tepërt i pesticideve dhe plehrave kimike, së bashku me metodologjitë tradicionale të kultivimit, kanë kontribuar në degradimin e mjedisit.
- Mungesa e Njohurive mbi Mjedisin: Shumë fermerë nuk janë të informuar mbi praktikën e mirë për ruajtjen e tokës dhe burimeve natyrore, duke e çuar në keqpërdorim të resurseve.

Grupet e prekura nga ky problem:

- Fermerët: Dëmtimi i tokës rezulton në uljen e prodhimit dhe cilësisë së produktit, duke rritur varfërinë në zonat rurale.
- Shoqëria Civile: Angazhohet për mbrojtjen e mjedisit, por has vështirësi për të ndikuar në politikën e qeverisë dhe për të rritur ndërgjegjësimin e fermerëve.
- Qeveria: Përballet me sfida për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe për të menaxhuar burimet natyrore.

4. Mungesa e kooperimit dhe bashkëpunimit mes prodhuesve

Përshkrimi i Problemit: Mungesa e kooperativave dhe strukturave organizative e pengon fermerët në përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve të tyre. Pa bashkëpunim, është e vështirë për fermerët të arrijnë shkallë më të lartë të prodhimit dhe efikasitetit. Kooperativat mund të ofrojnë mbështetje për ndarjen e kostove dhe burimeve, si dhe për tregtinë dhe marketingun e produkteve.

Shkaqet:

- Mentaliteti Individualist: Fermerët shpesh preferojnë të punojnë në mënyrë të pavarur, duke mos shfrytëzuar përfitimet e kooperimit dhe bashkëpunimit.
- Mungesa e Edukimit për Kooperativat: Informacioni mbi përfitimet e kooperativave dhe mënyrën e funksionimit të tyre është i limituar, duke penguar krijimin e strukturave të tilla.

Grupet e prekura nga ky problem:

- Fermerët: Dështojnë të rrisin të ardhurat dhe përballen me sfida të menaxhimit të produkteve dhe konkurrencës.
- Qeveria: Ka vështirësi në zhvillimin e politikave që inkurajojnë kooperimin dhe bashkëpunimin, duke e vështirësuar implementimin e strategjive për zhvillim rural. Këto probleme kërkojnë një qasje të integruar dhe të koordinuar nga të gjithë aktorët e prekur. Vetëm përmes ndryshimit të politikave, zhvillimit të infrastrukturës, mbështetjes për përdorimin e teknologjisë bëhet e mundur arritja e qëllimeve në mënyrë të kënashme dhe në kohë.

Problemi qëndron në faktin se mungesa e përdorimit të teknologjive të reja dhe investimeve në përmirësimin e cilësisë së tokës bujqësore ndikon negativisht në të gjithë zinxhirin bujqësor — duke filluar nga sasia dhe cilësia e prodhimit, niveli i të ardhurave dhe punësimit në bujqësi, e deri te rritja ekonomike përmes tregtisë dhe eksporteve, si dhe shëndeti i kafshëve në rastin e përdorimit të tokave si kullota. Megjithatë arritjet në sektorin e fruta/perimeve Shqipëria ende nuk i plotëson nevojat e veta të tregut dhe të konsumit. Kjo vjen si rezultat i një sërë faktorësh siç janë:

- humbjet në prodhim,

- sipërfaqen e vogël të fermës,
- mungesën e fuqisë punëtore (migrimi dhe emigrimi) si dhe
- nivelin e ulët të teknologjisë së prodhimit në disa zona dhe fermerë të caktuar,
- çmimet e larta të inputeve bujqësore,
- mungesës së unitetit midis prodhuesve (kooperimi), etj.,

Të gjithë këta faktorë bëjnë të domosdoshëm: thellimin e punës shkencore në fushën e prodhimit bimor, krahas politikave mbështetëse të Qeverisë, për realizimin e prodhimit të integruar për përballimin me sukses të sfidave të tregut në përgjithësi dhe globalizimit të tij në veçanti.

Kjo për faktin që suksesi i prodhimit dhe i marketingut bashkëkohor prodhimeve bujqësore varet nga shkalla e zbatimit të arritjeve të shkencës dhe teknologjisë bashkëkohore, shkalla e kualifikimit të specialistëve të fushës, shkalla e mekanizimit të proceseve të punës dhe marketingut, shkalla e mekanizimit të proceseve të punës dhe marketingut dhe mbi të gjitha shpejtësia dhe saktësia e informacionit⁶.

Konsolidimi i tokës bujqësore është një nga problematikat që haset me së shpeshti në Shqipëri. Mungesa e dokumenteve të pronësisë, mungesa e sigurisë së statusit të përcaktuar të tokës bujqësore, të dhënat e sakta kadastrale, rastet e mbivendosjeve si dhe çalimi në zbatimin e strategjive për konsolidimin janë aspekte frenuese në lidhje me zhvillimin e bujqësisë në vënd duke dhënë rezultate edhe më të vogla se vëndet e rajonit.

Sot, konsolidimi i tokës në shumicën e vendeve të Evropës Perëndimore është një nga instrumentet kryesore për zbatimin e projekteve që lidhen me zhvillimin e infrastrukturës publike dhe mbrojtjes së mjedisit, ku direktiva kuadër e BE-së për ujin dhe direktivat e Natura 2000 sigurojnë mundësi për përdorimin e konsolidimit të tokës, si një instrument i dobishëm për zbatimin e ndryshimeve në përdorimin e tokës, sipas përcaktimeve në këto direktiva. Në dallim nga kjo, disa vende të rajonit të Evropës Qendrore dhe Lindore, nëpërmjet programeve të konsolidimit të tokave në dekadën e fundit, kanë adresuar problemet e fragmentimit të tokës bujqësore dhe fermave me madhësi të vogël.

Gjithashtu, evidentohet një problem i rëndësishëm në funksionimin e tregut të tokës bujqësore në Shqipëri, i cili ende nuk është zhvilluar sipas standardeve të një ekonomie tregu të konsoliduar. Edhe pse ka një rritje të lehtë të madhësisë mesatare të fermave familjare dhe një numër të konsiderueshëm transaksionesh mbi tokën bujqësore, ky treg ende mbetet i fragmentuar dhe joefikas.

Një nga çështjet kryesore është se shumë nga transaksionet e tokës nuk bëhen me synimin për të zhvilluar sektorin bujqësor, por për ndryshimin e destinacionit të tokës nga bujqësore në truall ndërtimi ose për qëllime të tjera jo-bujqësore. Kjo tregon një mungesë të politikave efektive për mbrojtjen dhe përdorimin racional të tokës bujqësore, e cila mund të ndikojë në mënyrë negative në prodhimin bujqësor dhe në zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Një tjetër aspekt problematik është ritmi i ulët i konsolidimit të fermave. Ndërsa një pjesë e fermave familjare po japin me qira tokën e tyre, procesi i rritjes së madhësisë së fermave mbetet shumë i ngadaltë, gjë që tregon se pronarët ende nuk po bëjnë transaksione të mëdha që mund të çojnë në një bujqësi më të organizuar dhe produktive. Në këtë kontekst, mungesa

⁶ Burimi Ministria e Buqësisë dhe Zhvillimit Rural <https://www.bujqesia.gov.al/bujqesia-dhe-blegtoria/>

e një tregu aktiv, që mirëfunksionon për tokën bujqësore mund të pengojë investimet në bujqësi dhe të kufizojë zhvillimin ekonomik të zonave rurale.

Për më tepër, të dhënat mbi transaksionet e kryera tregojnë se vlera mesatare e tokës bujqësore (4.4 euro/m²) (në vitet 2011–2015 janë regjistruar mesatarisht në vit 3150 transaksione për tokën bujqësore për një sipërfaqe prej rreth 750 ha) mbetet relativisht e ulët, gjë që mund të sinjalizojë mungesë të kërkesës për tokë ekskluzivisht për zhvillim bujqësor. Kjo mund të jetë rezultat i mungesës së mekanizmave efektivë për nxitjen e blerjes dhe shitjes së tokës mes fermerëve ose të pasigurisë mbi të drejtat e pronësisë dhe kufizimeve ligjore për përdorimin e tokës.

Në përfundim, problematika kryesore e ngritur është se tregu i tokës bujqësore nuk funksionon ende si një mekanizëm i lirë dhe i zhvilluar sipas parimeve të ekonomisë së tregut, duke e orientuar një pjesë të madhe të transaksioneve drejt qëllimeve jo-bujqësore. Kjo mund të ketë pasojë afatgjatë në zhvillimin e bujqësisë, konkurrueshmërinë e sektorit dhe sigurinë ushqimore të vendit. Për këtë arsye, nevojiten masa të qarta për të stimuluar konsolidimin e fermave, për të mbështetur përdorimin bujqësor të tokës dhe për të rritur transparencën dhe funksionalitetin e tregut të tokës bujqësore.

Faktorët kufizues për zhvillimin e tregut formal të tokës rurale përfshijnë: perceptimin e tokës si një e ardhur sociale e sigurt; pretendimet e pazgjidhura dhe konfliktet mbi pronësinë e tokës; procesi i zgjatur dhe i kushtueshëm i transaksioneve mbi tokën, gabimet e bëra gjatë regjistrimit të kryer në kuadër të reformës së tokës (emrat, sipërfaqet, dokumentacioni) dhe mundësitë e pakta për kreditim bankar. Për shkak të perceptimit të titujve të pronësisë si të pasigurt, bankat shpesh refuzojnë të pranojnë titujt e pronësisë, si kolateral për blerjen e tokës.

Si rezultat i përdorimit intensiv dhe shpesh pa kritere të ekosistemeve natyrore, mjedisi në Shqipëri është i degraduar në një masë të konsiderueshme. Problemet kyçe mjedisore janë ndotja e ujit, ndotja e ajrit, degradimi i tokës, erozioni, si dhe humbjet e biodiversitetit (renditja nuk është sipas përparësisë). Edhe pse në Shqipëri reshjet janë të bollshme, me një tregues vjetor mesatar prej 1,485 mm, vetëm 20% e këtyre reshjeve ndodhin gjatë periudhës vendimtare të rritjes midis prillit dhe shtatorit. Si rezultat i këtij trendi, ku gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht, deficitin për bimët e kultivuara variojnë në 300–500mm, e bën ujitjen gjatë verës dhe kullimin gjatë dimrit një domosdoshmëri për të gjithë territorin e vendit. Erozioni i tokës, i cili është shkaktuar kryesisht nga praktikët e paqëndrueshme pyjore, bujqësore dhe kullimore, mbetet një shqetësim i madh. Erozioni prek 24% të territorit të vendit (mesatarisht tonë ha⁻¹ vit⁻¹) humbje të tokës, mjaft më i lartë se niveli “i qëndrueshëm” 10 tonë ha⁻¹ vit⁻¹, megjithatë më shumë se 60% e tokës së mbetur është, gjithashtu, shumë e ndjeshme ndaj erozionit të ujit, i cili është përshpejtuar nga prerjet e paligjshme të pyjeve.

Grupet e prekura nga këto problematika, në tërësi, janë:

- Operatorët e bizneseve;
- Qeveria;
- Fermerët;
- Shoqëria civile;
- Prodhuesit e blegtorisë;
- Industria përpunuese/prodhuese e produkteve me origjinë shtazore;
- Punëmarrësit.

Problemi mund të trajtohet vetëm përmes ndryshimit të politikave duke hartuar një kornizë solide të vetme ligjore.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*

Nëpërmjet kësaj nisme synohet të rritet efica e përdorimit të tokave bujqësore në administrim të MBZHR dhe të shtetit, kujdesi dhe mbrojtja e tokës bujqësore në tërësi dhe të fertilitetit të saj. Eliminimi i problematikave lidhur me keqpërdorimin e tokave bujqësore, dëmtimin e tyre, shfrytëzimin e pafrytshëm të tyre etj. Qëllimi kryesor i nismës është ofrimi i mbrojtjes maksimale të tokave bujqësore, rritja e mundësisë për qiradhënie dhe shfrytëzimi sa më efektiv për tokat bujqësore në administrim të MBZHR-së, rritje të prodhimit bujqësor përmes metodave që parashikon ky propozim, ulje e shpenzimeve energjitike, ujore dhe përdorim i teknologjive më inovative të përdorura sot në bujqësinë europiane me pasojë rritjen ekonomike për fermerin, shoqërinë, qeverinë etj. Adresimi i problematikave të evidentuara duke përditësuar dhe përcaktuar metoda dhe rregulla të reja, inovative dhe të përshtatshme lidhur me tokën bujqësore e cila ka rëndësi thelbësore për bujqësinë dhe zhvillimin e saj duke qenë në qendër të politikave të Qeverisë së Shqipërisë.

Kjo nismë është në përputhje me objektivat e nivelit të lartë të Qeverisë, të pasqyruara në dokumentat e mëposhtëm strategjikë:

1. Strategjia së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021/2027;
2. Programi Qeverisës 2021-2025.
3. Vendim Nr. 700, datë 12.10.2016 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për konsolidimin e tokës në Shqipëri”

Shqipëria ka një mundësi të shkëlqyer për të zhvilluar bujqësinë organike, në përputhje me objektivat e Strategjisë së BE-së “***Nga ferma në tavolinë***”, e cila synon që deri në vitin 2030 bujqësia organike të përfaqësojë 25% të sipërfaqes bujqësore. Kjo është gjithashtu në harmoni me shtyllën IV të Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, e cila nxit promovimin e praktikave bujqësore miqësore për mjedisin, organike, si dhe uljen e përdorimit të produkteve kimike sintetike në prodhimin e ushqimeve, përfshirë pesticidet, barnat veterinare dhe plehrat kimike. Përveç kësaj, kërkesa në rritje e tregut për produkte organike është një potencial dhe mundësi reale që duhet të shfrytëzohet. Përafrimi gradual me standardet e BE-së dhe promovimi i praktikave të mira për mirëmbajtjen e burimeve natyrore, si ajri, toka dhe uji (shih, gjithashtu, objektivin ndërsektorial). Aktualisht, praktikat e mira bujqësore promovohen sistematikisht në Shqipëri. Ato do të zbatohen nëpërmjet hartimit dhe futjes në zbatim të Kushteve të Mira Bujqësore dhe Mjedisore (KMBM) të thjeshtuara, përveç standardeve minimale ligjore dhe të cilat do të jenë të detyrueshme për përfituesit e mbështetjes së të ardhurave dhe pagesave kompensuese. Kuadri i standardeve të KMBM-ve synon të kontribuojë në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, në mbrojtjen e ujit, tokës dhe biodiversitetit .

Në Programin e Qeverisjes 2021-2025, Qeveria ka vendosur si synim ndërtimin e një ekonomie të fortë, të bazuar në modernizim, rritje të produktivitetit dhe konkurrueshmëri. Qëllimi është forcimi i drejtimit të zhvillimit ekonomik përmes modernizimit të sektorëve kyç si ekonomia prodhuese,

turizmi, bujqësia, ekonomia digjitale, konektiviteti dhe energjia. Nëpërmjet investimeve në zhvillimin teknologjik, synohet të nxitet një ekonomi prodhuese e qëndrueshme, ku bizneset ekzistuese dhe ndërmarrjet e reja do të krijojnë vlerë të shtuar për zinxhirin e prodhimit. Ndërmarrjet e manifakturës do të kalojnë nga modeli tradicional i përpunimit aktiv për markat ndërkombëtare, drejt një cikli të plotë prodhimi, duke promovuar markën “*Made in Albania*” dhe duke rritur aftësinë konkurruese të vendit në tregun global.

Prodhimi bimor është gjithashtu pjesë e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social të vendit, është pjesë e prioritetëve në Programin e Qeverisë, bën pjesë në Planin për Integrim Evropian dhe pjesë e Planit të Veprimit për Zbatimin e Partneritetit Evropian (2010-2014). Bazuar në nenet 71, 76 dhe 95 të MSA-së për fushën e prodhimit bimor, objektivi kryesor është përafrimi gradual i legjislacionit Shqiptar me atë Komunitar si edhe zhvillimi i strategjive për përdorimin e tokës, tregun e tokës, zhvillimin rural, diversifikimin e aktiviteteve fermere dhe rritjen e konkurrueshmërisë në bujqësi. Qëllimi i përgjithshëm është orientimi dhe sigurimi i një zhvillimi të qëndrueshëm të bimëve bujqësore me qëllim rritjen optimale të prodhimit për plotësimin sa më mirë të nevojave të vendit, minimizimin e importit, rritjen e mundësive për eksport si dhe mbështetjen e menaxhimit të këtij zhvillimi.

Arsyeja e ndërhyrjes së qeverisë, është investimi në cilësinë e tokës bujqësore si tërësi duke u kujdesur për të gjithë zinxhirin, që nga sasia dhe cilësia e prodhimit bujqësor, niveli i të ardhurave, niveli i punësimit në bujqësi, rritja ekonomike si rrjedhojë e shtimit të tregëtisë dhe eksporteve, shëndeti i kafshëve përmes ushqimit natyror më cilësor etj. Në këtë këndvështrim, duke marrë në konsideratë natyrën tepër të rëndësishme që ka toka bujqësore dhe përdorimi i inovacioneve në kontekst të prodhimit bujqësor propozohen ndryshimet në ligjin aktual në mënyrë që të arrihen objektivat e caktuara.

Shfrytëzimi efikas i tokave bujqësore me pjellori të ulët, të cilat aktualisht nuk shfrytëzohen, është një sfidë komplekse që kërkon një qasje të integruar. Kjo qasje duhet të marrë parasysh faktorë teknikë, ekonomikë, socialë dhe mjedisorë. Këtu janë zbatuar disa strategji dhe konsiderata kyçe për të arritur këtë qëllim:

- përdorimi i teknologjive inovative në përshtatje me tokat sipas tipit dhe pjellorisë për të identifikuar zonat më të përshtatshme për përmirësim dhe shfrytëzim;
- zgjedhja e kulturave të zgjedhja e kulturave që janë të përshtatshme për kushtet e tokës me pjellori të ulët dhe që kanë tolerancë ndaj thatësirës ose kripës kur kjo është e nevojshme;
- kultivimi i kulturave me vlerë të lartë me qëllim sigurimin për kthime ekonomike të volitshme edhe nga tokat me pjellori të ulët;
- rotacioni i kulturave për të përmirësuar pjellorinë e tokës, për të reduktuar rrezikun e sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe për të diversifikuar burimet e të ardhurave;
- praktika të qëndrueshme bujqësore në bujqësinë organike për të minimizuar përdorimin e pesticideve dhe plehrave kimike dhe për të promovuar shëndetin e tokës dhe biodiversitetin.
- zbatimi i praktikave të bujqësisë së konservimit si mbjellja e drejtpërdrejtë, mbulesa e tokës dhe rotacioni i kulturave për të reduktuar erozionin e tokës, për të përmirësuar strukturën e tokës dhe për të ruajtur ujin;
- zhvillimi i politikave që inkurajojnë shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokave bujqësore me pjellori të ulët dhe që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit.

Duke zbatuar këto strategji dhe duke marrë parasysh konsideratat e mësipërme, është e mundur të vihen në efikasitet tokat bujqësore me fertilitet të ulët, të cilat aktualisht nuk shfrytëzohen, duke kontribuar në sigurinë ushqimore, zhvillimin ekonomik rural dhe mbrojtjen e mjedisit.

Në përgjithësi, problematikat që janë identifikuar janë të natyrës rregullatore dhe ndërhyrja e qeverisë duhet të ndërmerret në funksion të arritjes së disa qëllimeve të shumëfishta të cilat lidhen me shfrytëzimin me efektivitet, mbrojtjen dhe kujdesin e vazhdueshëm lidhur me fertilitetin e tokës bujqësore përmes përcaktimeve sa më të përshtatshme si dhe konkretizimin e aktiviteteve që lidhen me teknologjitë inovative që do të përdoren në bujqësi si metodat e kultivimit agrifotovoltaik, aeroponia, hidroponia dhe akuaponia. Përdorimi i këtyre teknologjive të reja do të sjellë rritjen e investimeve dhe të prodhimit bujqësor duke shfrytëzuar dhe vënë në efikasitet toka bujqësore me pjellori të ulët.

Ndërkaq, rritja e investimeve nga subjektet private në sektorin bujqësor dhe në atë të peshkimit do të përkthehet në rritje të prodhimit bujqësor dhe të peshkimit. Investimet mund të financojnë teknologji të reja, praktika më të mira bujqësore, zgjerim të fermave dhe flotave të peshkimit, gjë që çon në rritje të sasisë dhe cilësisë së produkteve bujqësore dhe të peshkimit. Rritja e eksporteve të produkteve të prodhuara, sidomos për akuakulturat, është një objektiv i rëndësishëm për subjektet që do të investojnë në këtë sektor.

Bazuar në faktin se prodhimi i Bashkimit Evropian (BE) përfaqëson vetëm 1% të prodhimit global të akuakulturave dhe importon rreth 60% të saj, ekziston një potencial i madh për rritje dhe zhvillim në këtë fushë. Për të arritur këtë objektiv, synohen të ndërmerren disa hapa të rëndësishëm:

- investimet në teknologji të reja dhe moderne në akuakulturë mund të rrisë efikasitetin dhe cilësinë e prodhimit, duke e bërë më konkurrueshëm në tregun global;
- zhvillimi i produkteve me vlerë të shtuar duke u fokusuar në prodhimin e produkteve me vlerë të shtuar, të cilat mund të rrisin eksportet dhe të fitojnë të ardhura më të mëdha;
- promovimi i prodhimit vendor dhe mbështetja e fermerëve e mund të ndihmojë në rritjen e prodhimit dhe eksporteve;
- hapja e tregjeve të reja dhe negociimi i marrëveshjeve tregtare mund të rrisë eksportet dhe të diversifikojë tregjet e shitjes;
- përmirësimi i njohurive dhe krijimi i mundësive për trajnim për prodhuesit dhe për punonjësit në sektorin e akuakulturës mund të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së prodhimit;
- mbështetja dhe promovimi i prodhimeve lokale dhe të qëndrueshme duke vënë theksin në prodhimin lokal dhe të qëndrueshëm, duke ndikuar pozitivisht në krijimin e një imazhi pozitiv për prodhimet e vendit duke ndihmuar kështu në rritjen e eksporteve.

Nëpërmjet këtyre hapave, mund të rritet eksporti i produkteve të prodhuara, sidomos për akuakulturën, dhe të forcohet pozita e vendit në tregun global, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe në rritjen e të ardhurave.

Këto politika do të konsistojnë gjithashtu në zbutjen vështirësive që ekzistojnë si rezultat i mentalitetit të vjetër të fermerëve dhe përshtatjes së tyre në kushtet e reja të ekonomisë së tregut, uljen e kostos së inputeve bujqësore, organizimin e prodhimit dhe të shpërndarjes së produkteve bujqësore si dhe lehtësira në pajisjen e tregjeve.

Sektori i fruta/perimeve është renditur si një nga prioritetet e Sektorit të Bujqësisë që synon: mbështetje të prodhimit bujqësor, duke bërë të mundur futjen e përdorimit të teknologjive të reja në bujqësi si Friendly technologies (Teknologjitë Miqësore), GAP (Praktikat e Mira

Bujqësore), post-harvesting (praktikat e pas-vjeljes), etj., mbështetur këto në CAP (Politikat e Përbashkëta Bujqësore), organizimin e kooperativave të prodhuesve që tregtojnë vetë produktet e tyre, në ndihmë të standardeve të CMO (Organizimit të Përbashkët të Tregut). Duke marrë në konsideratë ndryshimet demografike në vend dhe ato globale, ndryshimin e preferencave të konsumatorëve, zhvillimin e teknologjisë së prodhimit-përpunimit-tregtimit, ndryshimin e burimeve njerëzore, ndryshimin financiar të vetë tregjeve si pasojë e rritjes në vazhdimësi të clusteringut në industri dhe rritjes së shërbimeve konsultative si dhe ristrukturimit të vetë rrjetit të ushqimit që në vetvete sjell ndryshimin e strategjive në nivelin e kompanive, lind si domosdoshmëri imediate hartimi i një politike të orientuar për zhvillimin e marketingut, duke e konsideruar bujqësinë si një prioritet gjithnjë në zhvillim që synon në prodhimin dhe tregtimin e produkteve të shëndetëshme (produktet organike), lehtësuese (gjysëm të gatshme), të vazhdueshme (kovejer për gjatë gjithë vitit) si dhe në restorante, etj.

Plani i zhvillimit të këtij sektori (përfshirë marketingun) synon të orientojë qartë linjat strategjike të zhvillimit të politikave dhe ndërhyrjeve në drejtim të:

2. rritjes së aftësisë konkurruese dhe promovimit të prodhimit bujqësor vendas në tregun vendas dhe të huaj;
3. rritjes së vlerës së produkteve dhe të ardhurave të fermerëve në Shqipëri;
4. përmirësimit e vazhdueshëm të teknologjive të prodhimit & informacionin e vlefshëm për to;
5. kosto të ulta transporti;
6. rritjen e aksesit për kreditim (lehtësira në teknologjitë e përparuara, financim në liberalizimin e tregut dhe telekomunikacion);
7. konsolidimin e industrisë përpunuese;
8. konsolidimin e magazinimit dhe shitjes me pakicë të produkteve;
9. rritjen e kërkesës për prodhuesit, përpunuesit në termat e arritjes së cilësisë, sigurisë, paketimit dhe standardeve të tjera për të kënaqur kërkesat e konsumatorëve për mbrojtje ligjore (siguria ushqimore).

Metodat që synohen të integrohen nëpërmjet kësaj nisme janë:

“Aeroponia” është teknika e kultivimit të bimëve duke i mbajtur rrënjët e tyre të varura në hapësirë, në të cilën aplikohet në mënyrë periodikisht ose pa ndërprerje, tretësira e plehërimit.

“Akuaponia” është një sistem i integruar bujqësie dhe akuakulture që kombinon rritjen e organizmave ujore (peshq ose kultura të tjera ujore) dhe kultivimin e bimëve në një cikël të mbyllur, ku mbetjet e organizmave ujore përdoren si lëndë ushqyese për bimët, ndërsa bimët ndihmojnë në pastrimin e ujit për organizmat ujore. Akuaponia është një sistem që për të njëjtën sipërfaqe prodhimi, ofron shumë më tepër prodhim dhe kjo e pakushtëzuar nga kushtet klimaterike dhe faktorët e jashtëm. Në këtë sistem arrihet kursimi në deri 90% të sasisë së ujit, si pasojë e riqarkullimit me cikël të mbyllur.

“Hidroponia” është teknika e kultivimit të bimëve në tretësirë ujore, e cila mund të përfshijë substrat inorganik (rërë, granit, perlit, lesh guri, gur vullkanik, etj.) ose organik (torfë, lëvoret e drurëve, lëvoret e arrës së kokosit, kashtë orizi, etj.). Kjo është një teknikë e përdorur gjerësisht në bujqësinë moderne për të rritur prodhimin kursyer ujin dhe zvogëluar përdorimin e pesticideve. Kjo është një metodë e kultivimit të bimëve e cila është veçanërisht e dobishme për zonat me tokë të varfër bujqësore, ose tokë me pjellori të ulët apo me mungesë uji si dhe përdoret shumë në ferma vertikale dhe serra moderne. Avantazhet e hidroponisë përfshijnë:

- Rritje më e shpejtë dhe rendiment më i lartë;
- Kursim i ujit shumë më i madh (rreth 90%) në krahasim me bujqësinë tradicionale;

- Përdorim më efikas i hapësirës;
- Më pak dëmtues të cilat përhapen nëpërmjet tokës.

“**Agrifotovoltaik**” është metoda e kombinimit midis aktivitetit bujqësor dhe prodhimit të energjisë së rinovueshme, ku parësor është aktiviteti bujqësor, etj. Kjo është metoda inovative që kombinon prodhimin e energjisë diellore me bujqësinë në të njëjtën sipërfaqe toke. Në këtë sistem panelet fotovoltaike vendosen mbi tokën bujqësore ose mbi serra duke lejuar bimët të rriten. Panelet diellore instalohen në atë mënyrë që:

- o lejojnë dritën e diellit të kalojë pjesërisht, në varësi të nevojave të bimëve;
- o mbrojnë bimët nga rrezet e forta të diellit, erërat e forta dhe breshëri;
- o prodhojnë elenergji elektrike e cila mund të përdoret për pompat e ujit, sistemet e ndriçimit ose të shitet në rrjetin elektrik.

Avantazhet e metodës “Agrifotovoltaike” janë:

- o përdorim i dyfishtë i tokës duke ndihmuar fermerët të përfitojnë si nga prodhimi bujqësor ashtu edhe nga energjia e rinovueshme;
- o mbron bimët nga ndryshimet klimatike duke reduktuar avullimin e ujit dhe i mbron nga temperaturat ekstreme;
- o kursen ujë sepse panelet krijojnë hije dhe zvogëlojnë nevojën për ujtitje;
- o Rrit të ardhurat sepse fermerët mund të shesin energjinë elektrike ose ta përdorin për serra dhe makineri.

Disa disavantazhe mund të jenë:

- o kosto fillestare e lartë për instalimin e paneleve;
- o nevojiten studime për vendosjen e duhur të paneleve në mënyrë efikase;
- o disa bimë mund të kenë nevojë për më shumë dritë dhe nuk përshtaten mirë.

Pavarësisht këtyre kjo metodë po përparon dhe po bëhet gjithmonë e më popullore për një bujqësi të qëndrueshme dhe të pavarur nga përdorimi i energjisë elektrike. Megjithë arritjet në sektorin e fruta/perimeve Shqipëria ende nuk i plotëson nevojat e veta të tregut dhe të konsumit. Kjo vjen si rezultat i një sërë faktorësh siç janë:

- humbjet në prodhim,
- sipërfaqen e vogël të fermës,
- mungesën e fuqisë punëtore (migrimi dhe emigrimi) si dhe
- nivelin e ulët të teknologjisë së prodhimit në disa zona dhe fermerë të caktuar,
- çmimet e larta të inputeve bujqësore,
- mungesës së unitetit midis prodhuesve (kooperimi), etj.,

Të gjithë këta faktorë bëjnë të domosdoshëm thellimin e punës shkencore në fushën e prodhimit bimor, krahas politikave mbështetëse të Qeverisë, për realizimin e prodhimit të integruar për përballimin me sukses të sfidave të tregut në përgjithësi dhe globalizimit të tij në veçanti.

Kjo për faktin që suksesi i prodhimit dhe i marketingut bashkëkohor i prodhimeve bujqësore varet nga shkalla e zbatimit të arritjeve të shkencës dhe teknologjisë bashkëkohore, shkalla e kualifikimit të specialistëve të fushës, shkalla e mekanizimit të proceseve të punës dhe marketingut, shkalla e mekanizimit të proceseve të punës dhe marketingut dhe mbi të gjitha shpejtësia dhe saktësia e informacionit .

Sipërfaqja gjithsej e njësive ekonomike bujqësore (fermës) është tërësia e terrenit të përbërë nga shumat e sipërfaqes bujqësore të përdorur (SBP) dhe sipërfaqes së tokës tjetër. Sipërfaqja bujqësore e përdorur (SBP) përbëhet nga:

- o tokë e punueshme (arë),
- o tokë e zënë me kultura drufrutore,
- o kopshtet e shtëpive dhe
- o kullotat e livadhet.

Me tokë të punueshme kuptojmë tokën e pluguar ose e lëruar rregullisht, sipas një sistemi të qarkullimit bimor. Qarkullimi bimor është praktika e rritjes alternative të kulturave bimore njëvjeçare në një fushë specifike sipas një modeli ose renditje të planifikuar në vitet prodhuese pasuese. Normalisht, kulturat njëvjeçare ndryshojnë çdo vit, por ato mund të jenë edhe shumëvjeçare (jonxhë). Për të dalluar tokën e punueshme nga toka e zënë me kultura drufrutore ose kullota e livadhe përdoret një prag prej pesë vjetesh. Sipërfaqja e kultivuar me bimë arash, është sipërfaqja e mbjellë me bimë arash në vitin bujqësor të dhënë. Këtu bëhet fjalë për sipërfaqe me kultura kryesore (të para). Këto kultura kryesore, normalisht kanë vlerë ekonomike më të lartë se kulturat e tjera dhe zënë tokën në pjesën më të madhe të vitit. Kulturat kryesore janë drithrat e bukës, kulturat e pranverës misri kokërr, patatja, fasulja, bimët industriale, foragjeret shumëvjeçare, etj.

Sipërfaqja e tokës tjetër, veç asaj të bujqësisë, përbëhet nga: sipërfaqja e zënë nga pyjet, sipërfaqja bujqësore e papërdorur dhe sipërfaqja jo bujqësore. Sipërfaqja e tokës bujqësore e kultivur është sipërfaqja totale e mbjellë për prodhimin e një kulture bujqësore specifike gjatë një viti të dhënë, nga e cila përjashtohet sipërfaqja e dëmtuar nga dëmtues natyror (përmbytjet, zjarret etj).

Aktualisht në sektorin e prodhimit bimor vihet re një rritje e prodhimit për çdo kulturë, ku rritja e prodhimit evidentohet më shumë në ambjente të mbrojtura (kemi një shtim të sipërfaqes së mbrojtur me 40 – 50 ha në vit dhe për vitin 2010 me 100 ha). Vlen të përmendet që si rrjedhojë e politikave mbështetëse të Qeverisë, nëpërmjet skemës mbështetëse për plastmasin në serra, etj., ky trend i rritjes së prodhimit ruhet nga viti në vit. Shqipëria me kushtet e saj klimatike, pozitën gjeografike si dhe traditën shumëvjeçare në kultivimin e perimeve dhe patates, ka mundësi potenciale për kultivimin e mbi 60 specieve perimore. Aktualisht kultivohen mbi 30 të tilla dhe trendi për rritjen e numrit të specieve sa vjen e rritet.

Ky fakt dhe faktorë të tjerë favorizues kanë bërë që prodhimi i perimeve aktualisht në disa zona potenciale të vendit, të shtrihet përgjatë gjithë vitit. E njëjta gjë vlen të përmendet për sektorin e frutikulturës ku si rezultat i politikave mbështetëse, që nga viti 2007 kemi një rritje të konsiderueshme të sipërfaqes së mbjellë me pemë frutore, ullinj, agrume, vresht, etj si dhe shërbimet e ujitjes, përpunimit, etj. Ku qëndron specifika e sektorit:

- o janë prodhime delikate që dëmtohen dhe prishen shpejt, kanë qëndrueshmëri të shkurtër pas vjeljes si dhe kërkojnë çdo ditë në treg;
- o prodhimi dhe marketingu i fruta/perimeve është aktivitet global dhe për rrjedhojë dhe ligjet e konkurrencës së sektorit janë prezent;
- o përballimi i kërkesave të tregut si: shumëllojshmëri dhe vazhdueshmëri në prodhimin e fruta/ perimeve të freskëta;

- o plotësim i shijeve të konsumatorit dhe siguri për produkte të shëndetshme;
- o rritja e vlerës së produktit duke siguruar manipulimin e pas-vjeljes;
- o standardet e transportit, ruajtjes, tregtimint deri në tavolinën e konsumatorit;

Në kushtet reale të lëvizjeve demografike të popullsisë vihet re një trend i ri në kultivimin e fruta/perimeve si rrjedhojë e:

- o përqëndrimin të fushës së prodhimit të fruta/perimeve rreth qyteteve (zhvillimi i bujqësisë periurbane dhe infrastruktura më e mirë rrugore dhe e marketingut);
- o prodhimi i specializuar dhe industrializuar i fruta/ perimeve në disa rajone;
- o rritja e sipërfaqes së ambjenteve të mbrojtura;
- o shtimi i llojshmërisë dhe varieteteve të tyre;
- o trajtimi pas vjeljes;
- o dominimi i supermarketeve në rrjetin tregtar.

Qeveria me politikat e saj synon të ndërhyjë për të:

- o siguruar përkrahje për industrinë agropërpunuese;
- o mbështetur prodhimet e fermerëve;
- o përmirësuar cilësinë e produktit me qëllim që të arrijnë standardet e BE-së;
- o siguruar mbrojtjen dhe sigurinë ushqimore për konsumatorin.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka ndërmarrë disa nisma në kuadër të shfrytëzimit sa më të favorshëm të tokave bujqësore, kjo e ndarë në disa aspekte siç janë: konsolidimi i tokës bujqësore (miratuar Startegjia e VKM Nr. 700/2016), bashkëpunimi me institucionet e tjera në vend kompetente për identifikimin e statusit të tokës bujqësore, parashikimet ligjore të cilat specifikojnë trajtimin, qiradhënien, mbrojtjen, përcaktimin specifik të tokave bujqësore në administrim të saj etj.

Në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë aktualisht ka një drejtori të posaçme, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, me sektorin për Administrimit dhe Mbrojtjen e Tokës të cilët kanë në përshkrimin e tyre të detyrave mbrojtjen, evidentimin e parcelave në varësi të MBZHR-së, të dhënat për këto parcela, të bashkëpunojnë me instanca të tjera shtetërore të qeverisë qëndrore dhe asaj lokale për mbrojtjen e tokës bujqësore etj. Veç kësaj po në MBZHR është krijuar dhe funksionon Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës i cili kryen funksione të inspektimit, bashkëpunimin me organet e tjera të shtetit të cilët kanë funksion inspektimit të tokës e bujqësore në administrim të shtetit etj.

Inspektoriati i Tokës pranë MBZHR-së, ka objekt veprimtarie ruajtjen dhe rehabilitimin e tokës bujqësore nga veprimi i dëmshëm i faktorëve klimatikë dhe njerëzore, të tilla si degradimi i tokës, erozioni, si dhe ndërtimet e paligjshme. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ushtron drejtimin teknik dhe administrativ të të gjitha strukturave shtetërore të ngarkuara me mbrojtjen e tokës. Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës për çdo 6 mujor ka për objektiv dhe përmbush këto detyra:

- organizimi dhe kryerja e kontrolleve të planifikuara në DAMT-të e Qarqeve, si dhe në Bashkitë respektive, si dhe kontrollet e mundshme për shkak të fenomeneve natyrore të paparashikuara.
- organizimi i takimeve të punës në dy faza, me punonjësit e DAMT-ve dhe Bashkive, mbi funksionimin e strukturave respektive dhe masat që duhen marrë për mbrojtjen e tokës bujqësore.

Specialisti i Inspektoratit kryen këto detyra:

- grumbullon, përpunon dhe analizon të gjitha ta dhënat e ardhura nga Këshillat e Qarqeve, Komisionet e Mbrojtjes së Tokës (KMT) dhe Inspektoriatet e Mbrojtjes së Tokës (IMT) të qarqeve. Në bazë të këtyre të dhënave përgatit raportet 6-mujore dhe vjetore për Komisionin Shtetëror të Mbrojtjes së Tokës (KSHMT) si dhe raporte të veçanta për çështje konkrete.
- kontrollon mbajtjen e dokumentacionit teknik për mbrojtjen e tokës bujqësore nga IMT-të dhe Zyrat e Menaxhimit të tokës (ZMMT) në bashki.
- evidentimi i tokës bujqësore për dëmtime nga faktorët njerëzorë (si ndërtimet e paligjshme, marrja e inerteve nga shtretërit e lumenjve, ndotja e tokave nga produktet kimike dhe materialet inerte, etj).

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat kryesore të politikës së këtij projektligji janë si më poshtë:

1. Sigurimi i zbatimit të teknologjive bujqësore inovative në tokat bujqësore për të rritur konkurrueshmërinë, produktivitetin dhe të ardhurat nga bujqësia, brenda vitit 2025;
2. Rritja me 20% e përdorimit të teknologjive inovative në bujqësi, si aeroponia, akuaponia dhe hidroponia, brenda 5 vitesh nga momenti i miratimit të nismës⁷;
3. Rritja me 20% të nivelit të investimeve inovatore nga subjektet private në sektorin bujqësor dhe të peshkimit, brenda 5 vitesh nga miratimi i nismës;
4. Krijimi i rreth 700 vende të reja pune përreth zonë ku do të kryhen investimet brenda një periudhë prej 5 vitesh nga miratimi i nismës;
5. Rritja me 10% e nivelit të eksporteve të produkteve bujqësore të prodhuara në vend brenda 5 viteve nga miratimi i nismës;
6. Shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe efikas i tokave bujqësore me fertilitet të ulët, të cilat aktualisht nuk shfrytëzohen, përafërsisht me 300 ha brenda një periudhë prej 5 vitesh nga miratimi i nismës;
7. Inkurajimi i praktikave të bujqësisë organike duke ofruar mbështetje financiare dhe teknike për fermerët.
8. Rritja e sipërfaqes së tokës organike me 50 ha brenda një periudhë prej 5 vitesh nga miratimi i nismës;
9. Krijimi i programeve kombëtare për trajnimin e fermerëve dhe punonjësve të sektorit bujqësor mbi teknologjitë moderne dhe praktikat e mira, brenda vitit 2026.

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjatë analizës së kryer, janë shqyrtuar të tre opsionet:

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së; Kjo qasje nënkupton që nuk do të ketë ndërhyrje në legjislacionin aktual dhe se problemet e evidentuara do të vazhdojnë të mbeten pa zgjidhje.

⁷ Lidhur me impaktin që do ketë teknologjia në sektorin e bujqësisë vlen të përmendet që ky është një indikator makro dhe performanca e sektorit bujqësor në vlerë monetare llogaritet nga INSTAT, për të bërë një vlerësim të tillë do kërkohej një analizë *ex ante* dhe *post ante* i impaktit të teknologjisë, nëpërmejet studimeve sektoriale.

Qëndrimi në gjendjen aktuale do të thotë që ligji ekzistues do të mbetet i pandryshuar dhe që do të injorohen problematikat e vazhdueshme në sektorin e bujqësisë. Avantazhet:

- ruajtja e status quo-së ofron një ambient të qëndrueshëm për fermerët dhe investitorët, duke evituar pasigurinë që mund të vijë nga ndryshime të papritura ligjore.
- nuk ka kosto: shmangia e shpenzimeve për rishikime ligjore dhe procese të reja miratimi.

Disavantazhet:

- problemet e evidentuara do të vazhdojnë të ndikojnë negativisht në sektorin e bujqësisë, siç janë fragmentarizimi i tokës dhe degradimi i mjedisit.
- do të pengohet përmirësimi dhe adoptimi i praktikave të reja dhe teknologjive, duke e bërë sektorin të pazhvilluar dhe të paefikas.

Opsioni 1 - (rregullator): Ky opsion parashikon miratimin e një ligji të ri dhe shfuqizimin e ligjit aktual “Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”. Megjithatë, ky opsion nuk ofron zgjidhje efektive për problematikat e evidentuara dhe nuk trajton nevojat aktuale të sektorit. Avantazhet:

- miratimi i një ligji të ri mund të sjellë një frymë të re dhe të nxisë besimin te fermerët dhe investitorët.
- një ligj i ri mund të ketë procedura më të thjeshta dhe më efektive për menaxhimin e tokës dhe mbrojtjen e saj.

Disavantazhet:

- pasiguria: shfuqizimi i ligjit ekzistues mund të krijojë një periudhë pasigurie për fermerët, derisa të implementohet ligji i ri.
- pamundësia për zgjidhjen e problematikave në një kohë të shpejtë. Hartimi i ligjeve të reja zakonisht kërkon një analizë të thellë dhe konsultime me palët e interesuara, si fermerët, ekspertët e sektorit dhe organizatat civile. Kjo mund të shkaktojë vonesa në proces.
- hartimi dhe miratimi i një ligji të ri paraqet kosto të larta të burimeve njerëzore dhe kohë të nevojshme për zhvillimin e këtij procesi.

Opsioni 2 - (rregullator): Kryerja e shtesave dhe ndryshimeve në Ligjin në fuqi “Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.

Ky opsion propozon rishikimin e Ligjit Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, me qëllim përmirësimin e tij dhe adresimin e çështjeve dhe problematikave të evidentuara.

Avantazhet:

- rishikimi mund të sjellë përmirësime konkrete dhe të adresojë problemet e identifikuar në mënyrë më efektive se miratimi i një ligji të ri.
- ruhet një nivel stabiliteti në sektor, pasi ligji ekzistues mbetet në fuqi, duke shmangur pasigurinë që mund të vijë nga shfuqizimi i tij.

- rishikimi do të përdorë njohuritë dhe eksperiencën e ligjit ekzistues, duke e bërë procesin më të përshtatshëm dhe të bazuar në praktikën e deritanishme.
- ndryshimet e propozuara nuk prekin më shumë se 50% të dispozitave të ligjit aktual dhe për këtë arsye, në kuadër të teknikës legislative ndryshimi i ligjit aktual vlerësohet si më optimal.
- ndryshimet në ligj do të kenë kosto më të ulëta krahasuar me hartimin e një ligji të ri.

Disavantazhet:

- rishikimi mund të marrë kohë dhe të vonojë zbatimin e zgjidhjeve për problematikat aktuale.
- nëse rishikimi nuk është i plotë dhe i thelluar, mund të mos arrijë të adresojë të gjitha çështjet, duke lënë problematikat të pazgjidhura.
- pavarësisht sfidave, ky opsion përfaqëson zgjidhjen më të plotë dhe afatgjatë për trajtimin e çështjeve që ai ofron dhe një bazë solide për të adresuar problematikat ekzistuese, për të harmonizuar politikat kombëtare me standarde të Evropës dhe për të ndërtuar një sistem efikas dhe të qëndrueshëm në fushën e politikës për tokat bujqësore.

Opsioni 3 (jorregullator)- Ky opsion parashikon forcimin e funksioneve që ushtrohen aktualisht nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e tokës bujqësore, pa nevojën e ndërhyrjeve rregullatore dhe përfshin:

- përforcimin e mbikëqyrjes dhe menaxhimit ekzistues të institucioneve përgjegjëse pa ndryshuar legjislacionin.

Qeveria mund të fokusohet në forcimin e zbatimit të rregulloreve dhe legjislacionit ekzistues, përmes trajnimeve dhe mbikëqyrjes më të fortë të institucioneve dhe operatorëve të sektorëve;

Inkurajimin e fermerëve dhe të shfrytëzuesve të tjerë të tokave bujqësore për zbatimin e metodave të reja inovative duke patur në vëmendje ruajtjen e biodiversitetit dhe cilësinë e pjellorisë së tokës bujqësore pa imponuar rregullore të reja. Kjo do të përfshinte fushata edukative dhe informuese, trajnime intensive jo vetëm për stafin mbikëqyrës e zbatues aktual por edhe fermerin, si dhe ofrimin e burimeve dhe udhëzimeve për të ndihmuar ata gjatë zbatimit të procesit.

Ky nuk është opsioni më efikas për adresimin e problematikave, pasi mënyrat për të zhvilluar bujqësinë, si dhe integrimi i mundësisë për përdorimin e paneleve diellore dhe prodhimin të energjisë diellore në bujqësi, janë të pamundura pa formalizimin e tyre përmes një paracaktimi rregullator. Kjo lidhet si me natyrën tepër inovative të teknologjive të reja, ashtu edhe me kostot fillestare të larta që ato paraqesin. Ndërkohë, lejimi i investimeve infrastrukturale për burime të energjisë fotovoltaike si pjesë e energjisë së rinovueshme në tokat bujqësore me bonitet nga 9 deri në 10 aktualisht nuk është i parashikuar në ligj dhe si i tillë nuk lejohet. Për të adresuar këto problematika dhe për të mundësuar integrimin e këtyre risive teknologjike, paraqitet e domosdoshme ndërhyrja në kuadrin aktual ligjor.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- Identifikoni se kush preket.
- Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.\
- Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.
 - Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni)

Grupet që preken janë:

- Operatorët e bizneseve;
- Qeveria;
- Fermerët;
- Komuniteti;
- Industria prodhuese e produkteve bujqësore;
- Punëmarrësit

o *Operatorët e bizneseve* –preken nga ky ligj pasi ligji parasheh normim të ri, rregulla dhe masa të reja për t'u plotësuar nga ana e operatorëve, kosto ekonomike për ta etj.

o *Qeveria* –rrit punësimin, plotëson kushtet lidhur me grupkapitullin, bujqësia, për të cilin u hapën negociatat, merr përsipër të drejta dhe detyrime që burojnë nga ky ligj etj.

o *Fermerët*- do të aplikojnë metoda të cilat parashikojnë kosto të konsiderueshme për ta por që do të përkthen në rritje e të ardhurave, rritje e fuqisë konkurruese në tregun e brendshëm, mundësinë e eksportit apo rritjen e eksportit, cilësi të produkteve, përmirësimin e kushteve të zhvillimit të veprimtarisë bujqësore për ta etj.

o *Shoqëria civile*- intensifikimi, zgjerimi dhe modernizimi i bujqësisë përforcon ofertën ekonomike dhe sociale në ato zona, duke sjellë një jetesë më të mirë për banorët ruralë, duke u ofruar të rinjve një mundësi më tepër punësimi dhe një ofertë ekonomike tërheqëse, dhe kështu edhe produkte më të mira dhe siguri më të lartë ushqimore etj.

o *Prodhuesit e produkteve bujqësore* –shtim i lidhur me prodhimin, cilësinë më të lartë dhe paisje me mjete prodhuese më të përshtatshme, sipas kushteve të ligjit, që i përshtaten kërkesave të tregut të brendshëm por edhe atij europian e që përmban edhe kosto.

o *Punëmarrësit* - më shumë mundësi punësimi si pasojë e hapjes së tregëtisë e eksportit, me shumë mundësi punësimi për profesionistët në fushën e bujqësisë etj.

Disa nga grupet e prekura kanë përfitime të drejtpërdrejta siç vijon:

Ndikimet sociale, ekonomike dhe mjedisore të hartimit të projektligjit të ri:

1. Ndikimet Sociale:

a. Operatorët e Bizneseve:

- Forcimi i tregut të brendshëm përmes rritjes së standardeve në cilësinë e produkteve.
- Rritja e mundësive për partneritete dhe bashkëpunime ndërkombëtare, veçanërisht me tregun europian.

- Përfitime të reja për punonjësit nga rritja e kërkesës për produkte cilësore, duke përmirësuar kushtet e punës dhe zhvillimin profesional të stafit.

b. Qeveria:

- Rritja e nivelit të investimeve në sektorin bujqësor dhe atë të peshkimit; .
- Rritja e nivelit të eksporteve për produktet e sektorit bujqësor;.
- Rritja e nivelit të punësimit në sektorin bujqësor apo edhe përrreth;
- Rritja e nivelit ekonomik në zonat rurale dhe për fermerëve, etj.

c. Fermerët:

- Rritje e standarteve të jetesës për komunitetet rurale përmes rritjes së të ardhurave dhe garantimit të sigurisë ushqimore.
- Sigurime të larta shëndetësore për fermerët dhe familjet e tyre si rezultat i praktikave të sigurta dhe më të kontrolluara të prodhimit.
- Rritje e sipërfaqeve të fermave, serrave dhe rritje e numrit të serrave që prodhojnë prodhime organike.
- Rritje e të ardhurave, përmirësim i kushteve të jetës në zona rurale, teknologji moderne, më pak punë krahu si rezultat i përdorimit të teknologjive inovative etj.

d. Punëmarrësit:

- Krijimi i vendeve të reja të punës, veçanërisht në zonat rurale, duke nxitur popullimin dhe zhvillimin e këtyre zonave.
- Mundësi për zhvillim profesional përmes programeve trajnuese në sektorët e përpunimit dhe bujqësisë.
- Më shumë të ardhura si pasojë e rritjes së tregut të veprimtarive bujqësore.

e. Komuniteti dhe shoqëria civile:

- Përfitime nga rritja e sigurisë ushqimore dhe cilësisë së produkteve organike.
- Përmirësimi i jetesës në zonat rurale përmes modernizimit të sektorit bujqësor dhe rritjes së eksportit për prodhimet bujqësore.
- Rritje e të ardhurave, përmirësim i kushteve të jetesës, më shumë mundësi punësimi, mundësi për zhvillimin e aktivitetit ekonomik privat në zonat rurale në bujqësi etj.

Ndikimet Ekonomike

- Operatorët e Bizneseve:

- Kosto fillestare në sektorin privat për të përmbushur normat dhe rregullat e reja ligjore për paisjen me teknologjitë, panelet të cilat do përdoren për funksionimin e metodave që parashikon projekligji, por që investimet do të përkthehen në përfitime afatgjata si rritja e eksportit dhe fitimeve, kurse në energjinë elektrike, përdorimin e ujit për vaditje, në disa raste mundësia e shitjes së energjisë elektrike etj.
- Hapja e tregjeve të reja në vendet e BE-së do të rrisë mundësitë për zhvillimin e ekonomisë vendase dhe rritjen e të ardhurave. Hapja e eksportit për kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore më vendet e BE-së pritet të sjellë jo vetëm hapjen

e një fushe të re në ekonominë e vendit, por edhe forcimin e tregut të brendshëm, rritjen e tregëtisë, rritjen e operatorëve të biznesit që do merren me tregëtinë, rritje e të ardhurave, investime më të mëdha në këtë fushë marrë në tërësi, do tregëtohen produkte me origjinë shtazore më të sigurta në treg etj.

- Qeveria:

- Rritje të ardhurash nga doganat dhe tatimet si rezultat i rritjes së eksportit dhe tregëtisë.
- Rritje e të ardhurave nga sigurimet shoqërore shëndetësore si rrjedhojë e rritjes së punësimit.
- Rritje e nivelit ekonomik të vendit si pasojë, e rritjes së nivelit të investimeve të brendshme dhe të huaja.
- Rritje e mirëqënies publike.

- Fermerët:

- Rritje e produktivitetit dhe fitimit si rezultat i standardeve të reja të biosigurisë dhe cilësisë.
- Mundësi për të aplikuar për subvencione dhe investime nga qeveria apo donatorë të huaj.
- Rritje e të ardhurave për shkak të rritjes së tregëtisë bazuar në parimin produkt i sigurtë-cilësi, rritje e mirëqënies.

- Prodhuesit e produkteve bujqësore:

- Përmirësimi i cilësisë së produkteve dhe rritja e mundësive për eksport konkurrues në tregje ndërkombëtare.
- Kosto fillestare për investime në teknologji dhe pajisje të reja, por kthimi i investimit pritet të sjellë rezultate të larta lidhur me prodhimin bujqësor, kursimin e energjisë dhe përdorimin e ujit për vaditje si edhe mundësinë e shitjes së energjisë në disa raste këto në afat të gjatë.

- Mbrojtja e tokës bujqësore ka një sërë ndikimesh ekonomike pozitive në disa fusha, duke përfshirë:

- siguria ushqimore: mbrojtja e tokës bujqësore siguron që të ketë tokë të mjaftueshme për të prodhuar ushqim për popullatën. Kjo zvogëlon varësinë nga importet e ushqimit dhe siguron një furnizim të qëndrueshëm ushqimi;
- stabiliteti i çmimeve: duke siguruar një furnizim të qëndrueshëm ushqimi, mbrojtja e tokës bujqësore ndihmon në stabilizimin e çmimeve të ushqimeve;
- rritja ekonomike lokale: bujqësia është një burim i rëndësishëm i të ardhurave dhe punësimit në zonat rurale. Mbrojtja e tokës bujqësore ndihmon në mbajtjen e këtyre vendeve të punës dhe të ardhurave, duke nxitur rritjen ekonomike lokale;
- turizmi: zonat bujqësore shpesh janë tërheqëse për turistët, të cilët vijnë për të shijuar peizazhet rurale, produktet e freskëta dhe aktivitetet bujqësore. Mbrojtja e tokës bujqësore ndihmon në ruajtjen e këtyre atraksioneve turistike dhe në gjenerimin e të ardhurave nga turizmi;
- shërbimet ekologjike: toka bujqësore ofron një sërë shërbimesh ekologjike, të tilla si rregullimi i ujit, ruajtja e karbonit dhe biodiversiteti. Mbrojtja e tokës bujqësore ndihmon në ruajtjen e këtyre shërbimeve, të cilat kanë vlera të rëndësishme ekonomike;

- reduktimi i kostove të infrastrukturës: duke parandaluar zhvillimin e pakontrolluar në tokën bujqësore, mbrojtja e tokës mund të reduktojë nevojën për investime të reja në infrastrukturë, të tilla si rrugë, ujësjellës dhe kanalizime;
- rritja e vlerës së pronës: toka bujqësore e mbrojtur shpesh ka një vlerë më të lartë se toka që është e hapur për zhvillim kjo për shkak se toka bujqësore e mbrojtur është e rrallë dhe e vlefshme për shkak të shërbimeve të shumta që ofron.

1. Ndikimet Mjedisore:

a. Operatorët e Bizneseve dhe fermerët:

- Rritja e standardeve të biosigurisë do të reduktojë ndotjen nga mbetjet bujqësore të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe të kafshëve, përdorimi i teknologjive të propozuara ka ndikim pozitiv në uljen e elementëve që ndikojnë në ndryshimet klimatike dhe ngrohjen globale.
- Investimet në infrastrukturën e fermave dhe serrave do të përmirësojë menaxhimin e burimeve natyrore.

b. Komuniteti:

- Produkte bujqësore më të sigurta, më shumë produkte organike, siguri ushqimore më e lartë në tërësi.
- Rritje e të ardhurave për shkak të hapjes së mundësisë për investime në bujqësi, më shumë mundësi për punësim, kërkesë më e lartë për profesionistë në fushën e bujqësisë.
- Përmirësimi i biodiversiteti në zonat rurale përmes praktikave më të qëndrueshme të prodhimit.

c. Qeveria:

- Përmes përmirësimit të kushteve në fermat bujqësore do të kontribuohet në ruajtjen e ekosistemeve dhe të balancës mjedisore.
- Rritje e mundësisë për punësit.
- Rritje e të ardhurave nga vjeljet e taksave doganore, sigurimet shoqërore, rritja e eksportit, përmbushje e standardeve europiane me fuqi konkurruese në tregun evropian etj.

Nga analiza e mësipërme duke vlerësuar kostot por edhe përfitimet dalim në përfundimin se të gjitha kostot dhe investimet që do të kryhen në këtë fushë janë kosto të cilat në plane afatgjata përkthehen në përfitime për aktorët e zinxhirit ushqimor dhe për shoqërinë në tërësi si dhe në një linjë me politikat e Qeverisë për plotësimin e kushteve për anëtarësimin në BE.

Kosto të drejtëpërdrejta në sektorin publik: Momentalisht nuk identifikohen kosto në sektorin publik pasi kompetencat e parashikuara me këtë ligj do të ushtrohen nga strukturat egzistuese të MBZHR-së dhe institucioneve të saj të varësisë.

Analiza sasiore e kostove është e pamundur të realizohet për arsye të mëposhtme, bazuar në informacionin e dhënë:

Të dhënat nga sektori privat janë të domosdoshme për të kuptuar kostot aktuale të operimit dhe ndikimet financiare të masave të propozuara. Në mungesë të këtyre të dhënave, është e pamundur të llogariten saktësisht kostot dhe përfitimet. Gjithashtu, ka mungesë të kriterëve të qarta. Pa informacion mbi kriteret specifike që operatorët privatë ndjekin, është e vështirë

të përcaktohen elementet që ndikonjnë në kosto, si për shembull: infrastruktura, personeli, materialet apo teknologjia. Vlerësimi i ndikimit ekonomik kërkon të dhëna mbi të ardhurat që gjenerohen nga sektori në fjalë. Mungesa e këtyre të dhënave e bën të pamundur krahasimin mes kostove dhe të ardhurave për të matur përfitimet neto. Kjo analizë varet edhe nga kompleksiteti i këtij sektori. Disa sektorë kanë variabilitet të lartë në funksion të operatorëve dhe veprimtarive të ndryshme. Mungesa e një baze të të dhënave për këto variacione ndërlikon më tej analizën.

Përfitime të drejtpërdrejta në sektorin publik: Qeveria përfiton hapjen e tregut të punës me krijimin e më shumë vende punë në sektorin privat por edhe në atë publik, pasi me zhvillimin e një ekonomie të re mund të rritet kërkesa për më shumë profesionistë në administratë, në më shumë të ardhura si pasojë e vjeljes së taksave, pagesave fiskale, të ardhura nga autoritetet doganore, paisjen me laboratorë të standarteve europiane etj. Në plan afatgjatë, fleksibiliteti i një kuadri të bazuar në rezultate do të imponojë uljen e ngarkesës së punës për administratën në fushën e bujqësisë por edhe në industrinë e lidhura me to. Duke pasur në fokus edhe hapjen e negociatave për disa grupkapituj në bujqësi, përmes miratimit të kësaj nisme ligjore jo vetëm plotësohet kuadri ligjor sipas standarteve të BE-së por në të njëjtën kohë synohet fillimisht të arrihet një impakt pozitiv në ekonominë e brendshme të vendit duke u krijuar vende të reja pune, duke garantuar mbrojtjen dhe fertilitetin e tokës bujqësore, përfitimi i investimeve të reja dhe rritja e interesit në këtë aspekt në vendin tonë gjithashtu rritja e mirqënies së shoqërisë si tërësi etj.

Kostot e drejtpërdrejta për sektorin privat: identifikohen kosto në sektorin privat me miratimin e këtij projektakti, por është e pamundur të plotësohet momentalisht nga ana jonë pasi në kushtet aktuale evidentimi i kostove apo të ardhurave që bashkëshoqërojnë biznesin në këtë veprimtari nuk arrihet të identifikohet, pasi kemi mungesë të dhënash nga operatorët në sektorin privat lidhur me kushtet e punës dhe kriteret.

Përfitimet ekonomike për sektorin privat: Për operatorët e bizneseve, fermerët, prodhuesit përfitimet janë – rritja e eksportit, forcimin e tregut të brendshëm, rritjen e tregëtisë, shtimin e operatorëve të biznesit që do merren me tregëtinë në bujqësi, rritje e të ardhurave, investime më të mëdha në këtë fushë marrë në tërësi, tregëtim i produkteve më të sigurta në treg etj. Për prodhuesit e produkteve bujqësore shtim i lidhur me prodhimin, cilësi më të lartë dhe paisje me mjete prodhuese më të përshtatshme, sipas kushteve të ligjit, që i përshtaten kërkesave të tregut të brendshëm por edhe atij europian e që përmban edhe kosto.

Ndikimi social i drejtpërdrejtë: Rritja e punësimit si dhe rritja e prodhimit bujqësor shtimi i mundësive për investime në fshat dhe në sektorin e bujqësisë por edhe të energjisë. Në këtë aspekt pritshmëritë për efektet pozitive të këtyre ndryshimeve ligjore janë të larta. Rritja e cilësisë së jetesës në zonat rurale, rritja e aktivitetit ekonomik dhe social në fshat, popullimi i zonave rurale dhe krijimi i kushteve optimale për rikthimin e emigrantëve duke krijuar një mjedis të volitshëm ekonomik.

Ndikim jo të drejtpërdrejtë: nëpërmjet këtij ligji parashikohet të aplikohen çmime më të arsyeshme për konsumatorin, si dhe produkte bujqësore cilësore dhe prodhime organike. Rritja e të ardhurave dhe ushqimit për familjet bujqësore, do të ketë ndikim edhe në standartin e jetesës, si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale, përmes produkteve ushqimore me çmime më të ulëta etj.

Ndikimi në mjedis: Projektligji ka sjellë risinë e përdorimit të metodave më inovative në bujqësi përmes përdorimit të teknologjive moderne, të cilat kanë funksione të shumëfishta jo vetëm në prodhim bujqësor por edhe prodhim energjie, ulje të mundësisë për përdorimin

e ujit për vaditje, tregëtim/shitje të energjisë së tepërt, përdorimin e paneleve diellore në serra etj. Të gjitha këto do të sjellin një sërë ndikimesh pozitive në mjedis, ky është qëndrimi shkencor teknik lidhur me këto metoda të kultivimit në bujqësi, qoftë në ruajtjen e mjedisit gjatë zhvillimit të bujqësisë dhe qoftë në aspektin e dhënies së kontributit ndaj uljes së efekteve të ndryshimeve klimatike në kuptim të ngrohjes globale.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimintuaj.

Opsioni 2–(rregullator)- Miratimi i këtyre ndryshimeve ligjore konsiderohet se ofron mënyrën më të mirë për të arritur objektivat. Ky opsion ofron qasjen më të mirë për thjeshtimin, qartësinë, koherencën dhe reduktimin e barrës administrative. Me miratimin e këtyre ndryshimeve ligjore synohet të rritet efienca e përdorimit të tokave bujqësore në administrim të shtetit, kujdesi dhe mbrojtja e tokës bujqësore në tërësi dhe të fertilitetit të saj. Eliminimi i problematikave lidhur me keqpërdorimin e tokave bujqësore, dëmtimin e tyre, mosshfrytëzimin e frytshëm të tyre etj. Qëllimi kryesor i këtij propozimi për ndryshime ligjore është ofrimi i mbrojtjes maksimale të tokave bujqësore, rritja e mundësisë për qiradhënie dhe shfrytëzimi sa më efektiv për tokat bujqësore, rritje të prodhimit bujqësor përmes metodave që parashikon ky propozim, ulje e shpenzimeve energjitike, ujore dhe përdorim i teknologjive më inovative të përdorura sot në bujqësinë europiane me pasojë rritjen ekonomike për fermerin, shoqërinë, qeverinë etj. adresimi i problematikave të evidentuara duke përditësuar dhe përcaktuar metoda dhe rregulla të reja, inovative dhe të përshtatshme lidhur me tokën bujqësore e cila ka rëndësi thelbësore për bujqësinë dhe zhvillimin e saj duke qënë në qëndër të politikave të qeverisë së Shqipërisë.

Për rrjedhojë, Opsioni 2 do të ketë një ndikim pozitiv në përfitueshmërinë dhe rritjen ekonomike të sektorëve të përfshirë.

Për të vlerësuar opsionet dhe për të bërë të mundur një krahasim më të saktë ndërmjet tyre është kryer analiza me shumë kritere dhe janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

Siç e kemi shpjeguar edhe më lart janë identifikuar katër opsione, si më poshtë vijojnë:

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së; Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma për ndryshime legjislative, nënkupton mos dhënien e një zgjidhjeje problematikave të evidentuara, mos adresimin e tyre dhe mos pasurimin me risi të ligjit në fuqi.

Opsioni 1 - (rregullator): Miratimi i një ligji të ri dhe shfuqizimi i ligjit aktual “Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” nuk jep zgjedhjen e duhur lidhur me problematikën të cilat janë evidentuar. Ky opsion nuk është i përshtatshëm, nuk trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh në kohë duke mos dhënë rezultatet e duhura.

Opsioni 2 - (rregullator): Rishikimi i ndryshimeve ligjore në ligjin aktual “Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, rregullon disa çështje në fushën e mbrojtjes së tokës bujqësore, parashikon përfshirjen e një sërë risish me të cilat do japin zgjidhje në kohë me afate të arsyeshme dhe përmes së cilave sigurohen arritjet e rezultateve të kënaqshme në përputhje me qëllimin për përqasje me modelet e ngjashme me vendet me bujqësi të zhvilluar dhe zbatimin e tyre në vend.

Opsioni 3 - (jorregullator)- Ky opsion parashikon forcimin e funksioneve që ushtrohen aktualisht pa nevojën e ndryshimit të ligjit të posaçëm në fuqi duke përforcuar mbikëqyrjen, monitorimin dhe menaxhimit e organeve kompetente ekzistuese pa ndryshuar legjislacionin.

Qeveria sipas këtij opsioni fokusohet në zbatimin më rigoroz të kuadrit rregullator dhe legjislacionit ekzistues, përmes ofrimit të trajnimeve të nevojshme dhe ushtrimit të mbikëqyrjes më të fortë të institucioneve dhe operatorëve të sektorëve në njërën anë dhe në anën tjetër inkurajimin e fermerëve dhe shfrytëzuesve të tjerë të tokave bujqësore për zbatimin e metodave të reja inovative duke patur në vëmendje ruajtjen e biodiversitetit dhe cilësinë e pjellorisë së tokës bujqësore pa imponuar rregullore të reja. Kjo do të arrihej përmes fushatave edukative dhe informuese, trajnimeve intensive jo vetëm stafit mbikëqyrës e zbatues aktual por edhe vet fermerin si dhe ofrimin e burimeve dhe udhëzimeve për të ndihmuar ata gjatë zbatimit të procesit.

Ky opsion nuk është zgjedhja e duhur në rastin konkret kjo pasi metodat e reja që propozohen përmes këtij ndryshimi ligjor, veç përparësive dhe vlerës së shtuar që sjellin, përmbajnë edhe kosto fillestare për zbatimin e tyre, gjë që prodhon hezitim te fermeri apo operatorët e tjerë të këtij zinxhiri në ndërkohë që metoda agrifotovoltaike jo vetëm nuk është pjesë e legjislacionit por edhe momentalisht e ndaluar nga legjislacioni aktual. Për këto arsye MBZHR ka vendosur që risitë ti sjellë përmes parashikimeve dhe nderhyrjeve të nevojshme në legjislacion.

Vendosja e peshës së kritereve sipas rëndësisë relative.

1. Efektiviteti i përdorimit të teknologjive e sistemeve inovative-4
2. Efektiviteti në shtimin e investimeve nga subjektet private në sektorin bujqësor dhe për rrjedhojë rritja e prodhimit bujqësor e peshkimit- 5
3. Efektiviteti në krijimin e vendeve të reja të punës përreth zonës ku do të kryhen investimet- 4
4. Efektiviteti në rritjen e eksporteve të produkteve bujqësore të prodhuara- 5
5. Krijimi i mekanizmave për vënien në efikasitet të tokave bujqësore me fertilitet të ulët, të cilat aktualisht nuk shfrytëzohen-5
6. Kosto – efektiviteti. 5

Për të bërë dallimin e opsioneve nga njëra-tjetra dhe me qëllim përzgjedhjen e opsionit më të mirë secili kriter është vlerësuar me një peshë specifike vlerësuar nga 1-5. Gjithashtu, secili kriter në varësi të peshës së tij, është vlerësuar me pikë përkatëse sipas shkallës së preferencës për çdo opsion për secilin kriter nga 0-5 ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Matrica e performancës: Matrica e performancës:

Kriteret	Pesha (Rëndësia relative)	Opsioni 0		Opsioni 1		Opsioni 2		Opsioni 3	
		Pikë	Vlera	Pikë	Vlera	Pikë	Vlera		Vlera

			(= Peshë x pikë)		(=Peshë x pikë)		(=Peshë x pikë)	Pikë	(=Peshë x pikë)
Efektiviteti i përdorimit të teknologjive e sistemeve inovative	4	0	0	4	16	4	16	1	4
Efektiviteti në shtimin e investimeve nga subjektet private në sektorin bujqësor dhe për rrjedhojë rritja e prodhimit bujqësor e peshkimit	5	0	0	5	25	5	25	1	5
Efektiviteti në krijimin e vendeve të reja të punës përreth zonë ku do të kryhet investimet-	3	0	0	3	9	3	9	1	3
Efektiviteti në rritjen e eksporteve të produkteve bujqësore të prodhuara	3	0	0	3	9	3	9	1	3
Krijimi i mekanizmave për vënien në efikasitet të tokave bujqësore me pjellori të ulët, të cilat aktualisht nuk shfrytëzohen.	4	0	0	4	16	4	16	2	8

Kosto-efektiviteti	5	1	5	3	15	5	25	2	10
Pikët totale për secilin opsion			5		90		100		33

Analiza me shumë kriteret tregon se opsioni 2 (rishikimi i ligjit aktual “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”) është vlerësuar me më shumë pikë dhe është zgjedhur si opsioni i preferuar.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Në nivel kombëtar, funksionet për konsolidimin e tokës, i janë besuar ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, ose një institucioni të autorizuar prej saj. Hartimi i planit të rishpërndarjes/riparcelimit, është normalisht, pjesa më thelbësore e punës në terren, që mund të kryhet së bashku, nga institucionet publike dhe kontraktuesit privatë.

MBZHR-ja do të mbetet autoriteti drejtues për konsolidimin e tokës ndaj si e tillë, ajo mban përgjegjësinë kryesore në zbatimin e Programit Kombëtar për Konsolidimin e Tokës (kuadri ligjor, përgatitja e planeve vjetore; sigurimin e shpalljeve publike për kompanitë private, sigurimin e burimeve financiare, garantimin e koordinimit gjatë zbatimit të projektit etj.).

Aktualisht, praktikat e mira bujqësore promovohen vazhdimisht në Shqipëri. Ato do të zbatohen nëpërmjet hartimit dhe futjes në zbatim të Kushteve të Mira Bujqësore dhe Mjedisore (KMBM) të thjeshtuara, përveç standardeve minimale ligjore dhe të cilat do të jenë të detyrueshme për përfituesit e mbështetjes së të ardhurave dhe pagesave kompensuese. Kuadri i standardeve të KMBM-ve synon të kontribuojë në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, në mbrojtjen e ujit, tokës dhe biodiversitetit .

Zbatimi i opsionit të zgjedhur do të realizohet në përputhje me dispozitat përcaktuese të këtij projektligji siç vijon:

- a) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- b) Komiteti Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës (KSHMT);
- c) Struktura përgjegjëse për inspektimin e mbrojtjes së tokës bujqësore;
- ç) Këshilli i Qarkut;
- d) Komisioni i Mbrojtjes së Tokës (KMT) në qark;
- dh) Struktura përgjegjëse për inspektimin e mbrojtjes së tokës bujqësore në qark;
- e) Këshilli i Bashkisë;
- ë) Kryetari i Bashkisë.

- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, është përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën mbrojtjes dhe shfrytëzimit të tokave bujqësore në administrim të MBZHR-së. Si autoriteti kompetent qendror MBZHR koordinon punën e institucioneve të varësisë. MBZHR-së, përmes strukturave të saj, ka objekt veprimtarie ruajtjen dhe rehabilitimin e

tokës bujqësore nga veprimi i dëmshëm i faktorëve klimatikë dhe njerëzore, të tilla si degradimi i tokës, erozioni, si dhe ndërtimet e paligjshme. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ushtron drejtimin teknik dhe administrativ të të gjitha strukturave shtetërore të ngarkuara me mbrojtjen e tokës. Konkretisht MBZHR kryen këto funksione:

- a) Koordinon zbatimin dhe monitorimin e strategjisë së konsolidimit të tokës;
- b) Harton dhe përshtat programin kombëtar të konsolidimit të tokës;
- c) Financon, mbikëqyr dhe garanton zbatimin normal të projekteve të konsolidimit të tokës;
- d) Përzgjedh dhe kontraktin entet për zbatimin e projektit;
- e) Siguron mbështetjen metodologjike për zbatimin e projekteve të konsolidimit të tokës;
- f) Përzgjedh fshatrat për pjesëmarrjen në program bazuar në aplikimet e pranuar;
- g) Lehtëson paraqitjen e planit të riparcelizimit/rishpërndarjes të tokës për miratimin e tij nga ana e KKT-së, si dhe regjistrimin e mëvonshëm nga ana e ZVRPP-së;
- h) Identifikon nevojat për trajnim së bashku me hartimin dhe zbatimin e programeve për ngritjen e kapaciteteve;
- i) Vendors marrëdhënie bashkëpunimi me ministritë e ndryshme dhe me agjencitë partnere;
- j) Përgatit raportet vjetore mbi zbatimin e strategjisë.

- **Komiteti Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës**, nën drejtimin e Ministrit të Bujqësisë, krijohet si organ ndërministror dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi të bashkërendojë punën e MBZHR, Ministrisë së Mjedisit, institucioneve të tjera, si dhe organeve të qeverisjes vendore, të ngarkuara nga ky ligj për mbrojtjen e tokës, për të gjitha veprimtaritë që kryhen mbi tokën bujqësore, lidhen me të dhe ndikojnë në mbrojtjen e tokës bujqësore etj.

- **Këshilli i Qarkut**, me strukturat në varësi të tij, ka këto detyra: drejtimin administrativ dhe teknik të të gjitha strukturave shtetërore në territorin e qarkut që ky ligj i ngarkon për mbrojtjen e tokës bujqësore; nxjerrjen e vendimeve të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha organet e pushtetit vendor në territorin e qarkut: për masat konkrete të mbrojtjes së tokës bujqësore; për miratimin e fondeve të nevojshme për mbrojtjen dhe rehabilitimin e tokës bujqësor mbi bazën e propozimeve të paraqitura nga KMT-ja ose IMT-ja e komunave etj.

- **Komisioni i Mbrojtjes së Tokës** ka këto detyra: bashkërendimin e veprimtarive për mbrojtjen e tokës bujqësore pranë këshillit të qarkut krijohet Komisioni i Mbrojtjes së Tokës (KMT); organizon grupe të veçanta me specialistë të institucioneve të ndryshme në territorin e qarkut për të verifikuar, kontrolluar ose studiuar çështje të veçanta për masat mbrojtëse për tokën bujqësore etj.

- **Këshilli i Komunës ose Këshilli i Bashkisë**. Kryetari i komunës ose kryetari i bashkisë ka këto detyra: të bëjë kontrollin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji brenda juridiksionit të tij; të nxjerrë vendime të detyrueshme për zbatim, për mbrojtjen e tokës bujqësore nga pronarët dhe poseduesit e ligjshëm të tokës bujqësore, si dhe për persona fizikë e juridikë, veprimtaria e të cilëve në çfarëdo lloji mënyre ndikon mbi funksionet që përmbush toka bujqësore; të shqyrtojë raportet e kontrolleve për dëmtimin e tokave bujqësore dhe të nxjerrë vendimet përkatëse etj.

- Detyra të tjera të strukturave shtetërore për mbrojtjen e tokës bujqësore bëjnë inspektimin e tokave bujqësore; monitorimin etj.

Pengesat e mundshme gjatë zbatimit të opsionit të zgjedhur mund të jenë:

1. Vonesat në zbatimin e legjislacionit nga ana e sektorit privat apo institucioneve e tjera ligjzbatuese, mungesa e teknologjisë sipas kërkesave specifike të kërkuara etj.

2. Një pengesë tjetër e mundshme mund të jetë mungesa e trajnimit të nevojshëm ose paisjet e pamjaftueshme për monitorimin zbatimin e standarteve të reja nga ana e strukturave ekzistuese mbikëqyrëse dhe inspektuese.
3. Hezitimi nga ana e fermerëve apo sektorit privat për përdorimin e metodave të parashikuara më këtë projekligj për shkak se janë ende të panjohura për vëndin tonë por edhe sepse fillimisht paraqesin kosto financiare të konsiderueshme.
4. Operatorët më të vegjël dhe fermerët me burime të kufizuara mund të përballen me vështirësi më të mëdha krahasuar me operatorët më të mëdhenj ose ata që tashmë punojnë me standarde ndërkombëtare.
5. Operatorët dhe institucionet mund të kenë vështirësi në përshtatjen e praktikave të tyre me standardet specifike të BE-së, për shkak të mungesës së përvojës ose ekspertizës teknike.

Të gjitha këto mund t'i vonojnë efektet e pritshme pozitive të ligjit, por gjithsesi nuk e ndalin zbatimin e tij të plotë në të ardhmen.

Disa nga masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës janë:

- Gadishmëria administrative për të ofruar prezantime, trajnime apo mënyra të tjera reklamimesh të informacionit mbi këto metoda për t'i bërë ato të njohura dhe për nxitjen e besimit të publikut nga rregullimeve të reja ligjore.
- Gadishmëria institucionale për të ofruar asistencë gjatë zbatimit të ligjit për sektorin privat;
- Dhënia e mundësisë për paraqitjen e mendimeve të sektorit publik lidhur me risitë e projekligjit si gjatë procesit të sektorit privat po edhe gjatë takimeve të ndryshme të zhvilluara lidhur me qëllimin e njohjes së tij.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Inspektoriati i Tokës pranë MBZHR-së, ka objekt veprimtarie ruajtjen dhe rehabilitimin e tokës bujqësore nga veprimi i dëmshëm i faktorëve klimatikë dhe njerëzore, të tilla si degradimi i tokës, erozioni, si dhe ndërtimet e paligjshme. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ushtron monitorimin e të dhënave, drejtimin teknik dhe administrativ të të gjitha strukturave shtetërore të ngarkuara me mbrojtjen e tokës.

Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës çdo 6 muaj ka për objektiv dhe përmbush këto detyra, që do të shërbejnë edhe si masa/mekanizma mbështetës për monitorimin e zbatueshmërisë së opsionit të preferuar. Detyrat e Inspektoriatit të Tokës pranë MBZHR-së janë:

- Organizimi dhe kryerja e kontrolleve të planifikuara në DAMT-të e Qarqeve, si dhe në Bashkitë respektive, si dhe kontrollet e mundshme për shkak të fenomeneve natyrore të paparashikuara.

- Organizimi i takimeve të punës në dy faza, me punonjësit e DAMT-ve dhe Bashkive, mbi funksionimin e strukturave respektive dhe masat që duhen marrë për mbrojtjen e tokës bujqësore.

Specialisti i Inspektoratit kryen këto detyra:

- Grumbullon, përpunon dhe analizon të gjitha ta dhënat e ardhura nga Këshillat e Qarqeve, Komisionet e Mbrojtjes së Tokës (KMT) dhe Inspektoriatet e Mbrojtjes së Tokës (IMT) të qarqeve. Në bazë të këtyre të dhënave përgatit raportet 6-mujore dhe vjetore për Komisionin Shtetëror të Mbrojtjes së Tokës (KSHMT) si dhe raporte të veçanta për çështje konkrete.
- Kontrollon mbajtjen e dokumentacionit teknik për mbrojtjen e tokës bujqësore nga IMT-të dhe Zyrat e Menaxhimit të tokës (ZMMT) në bashki.
- Evidentimi i tokës bujqësore, dëmtuar nga faktorë njerëzorë (si ndërtimet e paligjshme, marrja e inerteve nga shtretërit e lumenjve, ndotja e tokave nga produktet kimike dhe materialet inerte, etj).

Për të kryer një monitorim sa më efikas të zbatimit të projektligjit do të përdoren dhe shërbejnë edhe:

1. Të dhënat që disponohen nga sektorët përgjegjës për mbajtjen e statistikave si dhe sektori për monitorimin e zbatimit të kontratave për qiradhënien, të dhënat sa toka bujqësore në varësi të MBZHR janë dhënë më qira pas fillimit të zbatimit të projektligjit;
2. Të dhëna mbi sa të sukseshme kanë qënë në zbatim metodat e propozuara nga ana e institucioneve të varësisë së MBZHR-së por edhe nga monitorimi i zbatimit të Kontratës në MBZHR;
3. Treguesit e performancës, që ndihmojnë në matjen e progresit në krahasim me objektivat e vendosura;
4. Vlerësimi i riskut, i cili identifikon rreziqet dhe përcakton prioritetet për veprime të ardhshme;

Për të matur arritjen e objektivave të programeve të çrrënjësjes dhe për të siguruar një proces të efektshëm monitorimi, kriteret e matjes duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe të përcaktuara në kohë (SMART). Më poshtë paraqiten disa prej tyre:

1. Numri i fermerëve që përdorin një prej teknologjive inovatore të propozuara;
2. Sipërfaqja e tokave bujqësore të shtuara dhe rehabilituara;
3. Numri i vendeve të reja të punës të krijuara në sektorin bujqësor dhe atë të peshkimit;
4. Niveli i investimeve në këtë sektor krahasuar me periudhën përpara ndërmarrjes së kësaj politike, krahasuar me periudhën përpara miratimit të projektligjit;
5. Sipërfaqja e tokave organike të shtuara nga momenti i miratimit të projektligjit;
6. Sipërfaqja e tokave bujqësore me pjellori të ulët, të cilat janë rivendosur në përdorim;
7. Niveli i transporteve të produkteve bujqësore/organike/peshkimit, krahasuar me periudhën përpara miratimit të projektligjit.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktorizbritës										
Kosto për buxhetin – njëherë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorizbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorizbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsiioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionëlekë		Vlera aktuale neto në milionëlekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			